

INTERVISTË ME RAFET RUDIN

Prishtinë | Data: 21 janar, 2017

Kohëzgjatja: 204 minuta

Të pranishëm:

1. Rafet Rudi (I intervistuari)
2. Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
3. Petrit Çeku (Intervistuesi)
4. Donjetë Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Rafet Rudi: Mirë, unë jom Rafet Rudi, kompozitor i lindur me 5 janar, 1949, në Mitrovicë.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu për familjen e juaj, fëmijërinë e hershme?

Rafet Rudi: Qe kshtu, domethënë unë i takoj ni familje gjakovare, që ka qenë e shpërngulur prej Gjakovës në Mitrovicë për shkaqe, sipas të gjitha gjasave për shkaqe ekonomike domethënë, dhe ajo ka qenë familje domethënë që është shpërngulë mes dy luftrave botrore. Babai im, për shembull ka pasë ni dyqan, tregtar ka qenë, dhe kjo osht' bo për shkak se Mitrovica ka qenë ni qytet shumë ma, domethënë ma i gjallë. Nji qytet industrial, për dallim nga Gjakova që s'ka pasë lëvizje dhe nuk ka pasë punësim, nuk ka pasë domethënë natyrisht fabrika e kshtu me radhë, kurse krejt këto kanë qenë në Mitrovicë. Mitrovica domethënë ka qenë, që do ta shofim besoj edhe ma vonë n'bisedë një qytet relativisht i hapur ose qyteti më i hapur mund t'them në Kosovën e athershme. Pikërisht për faktin se ka qenë qytet industrial dhe domethënë punsimi ka qenë i njerzve nga qendra të ndryshme si duket edhe nga bota dhe natyrisht një jetë ma dinamike ka qenë, dhe aty e kanë pa shansën nji mori familjesh gjakovare. Dhe praktikisht osht' interesant në Mitrovicë ata kanë jetu si lloj enklave, shumë, shumë çuditshëm. Pse po e them këte, për shkak se deri...n'tërë fëmininë, domethënë mu më kanë dallu ta zamë si gjakovar, shumë interesante.

Kurse unë i lindun jom aty edhe, edhe vllaznit edhe motrat, unë i kom pasë dy motra, domethënë njena është ende gjallë, dhe dy vllazën që janë ende gjallë, dhe osht' interesant ni familje jo e pasur, jo e pasur por si duket mjaft e orientume për shkak babait tim në arsimim. Për ate dhe, domethënë n'atë familje unë kom qenë ma i vogli a po, domethënë t'gjithë ma t'rritur kanë qenë, dhe t'gjithë kanë studju, dhe osht' interesant t'gjithë kanë studju jashtë Prishtinës. Osht' interesant. Domethënë, motra ime është gjeneratë ndoshta e Servetit, që nuk është gjallë, e intelektualëve t'parë që kanë studju në Beograd, domethënë ky është viti '55-'56, domethënë kur, ta zamë në Kosovë.... E dihet mirëfilli se femnat kanë qenë domethënë në procesin e mbulimit domethënë a po, kurse ajo ka qenë ose të mbulohet, a po, domethënë, ose... apo do t'vazhdon studimet, dhe ajo ka vazhdu studimet. Dhe në Beograd ka studju dhe matematikën. Krejtsisht, krejtsisht e çuditshme. Si duket ajo ka qenë domethënë një dëshirë e babait tim dhe natyrisht edhe unë e kom pasë në njifarë mënyre fatin e kësaj familje.

Erëmirë Krasniqi: A t'kujtohet naj detaj prej jetës në Mitrovicë ashtu... m'u dok interesant që thatë që ju kanë identifiku si gjakovarë?

Rafet Rudi: Shiqo, ajo, ajo osht' nji, nji, jo ndoshta detal, nuk, nuk e kemi, nuk e thashë në kuptimin e

keq të fjalës... eh po, nuk është çështja aty, por ai osht' një mes, ka qenë mjaft i mbyllur qysh dihet domethënë ajo shoqëri, shoqëria kosovare n'atë kohë ka qenë jashtzakonisht... domethënë e mbyllun, qytetet, fshatrat a po? S'ka pasë komunikim të madh, a po... dhe Mitrovica ta zamë e ka pasë atë rrethin e vet dhe aty jonë njoft njerzt, qyteti shumë ma i vogël se n'krahasim me popullatën që sot ekziston a po, dhe ato, për ate ato dallimet jonë vrej a po. Por duhet t'thënë edhe diçka, se Mitrovica e asaj kohe ka qenë Mitrovicë kshtu heterogjene n'pikpamje të shoqërisë. Domethënë, ka pasë turq, ka pasë serb, po... por jo nuk ka qenë ndarja shumë e madhe.

Ta zamë n'atë rrethin ne që i thonim n'mahallën tonë a po, ne kemi pasë fqinjë Serb, a po? Për ate edhe përgjithsisht gjenerata ime, domethënë moshatarët e mi e kanë fol serbishten relativisht mirë, për dallim nga qytetet tjera, ndoni qytet tjetër. Mos t'flasim për Gjakovën a po, që fare s'kanë ditë të flasin serbisht. Mandej kanë ditë edhe turqisht por ajo ka qenë kohë edhe kur ka fillu një shpërngulje shumë e madhe e shqiptarëve për Turqi, siç dihet historikisht. Bile, shpinë që ne e kemi, që e kemi ble që kemi jetu në Mitrovicë, ka qenë e ni personi i cili është shpërngulë në Turqi, dhe ajo strukturë, them ajo, ai heterogjinitet nacional e ka bo këtë specifikë të Mitrovicës atëherhshme. Dhe kjo ka vazhdu edhe ma vonë, a po? Edhe në... ta zamë, ta zamë edhe në shkollën fillore, shkollën e mesme time edhe n'kohën kur kom fillu të merrem me muzikë ato kanë qenë komunikimet krejtsisht t'them normale a po, domethënë.

Çka osht', çka më lidhë me atë me atë ambient? Më lidhë, se unë domethënë e kom mësu mirë gjuhën serbo-kroate ne i thonim atëherë, dhe literatura ka qenë në serbishte a po, domethënë qoftë revistat, domethënë në shtëpinë tonë ne kemi pasë bibliotekë, sigurisht jo këtë bibliotekë që e kom tash, por ajo ka qenë një traditë, a po. Mu m'kujtohet edhe m'vjen keq që nuk osht' rujt ajo, por ne për shembull unë, vllau Agimi, Myrvetja domethënë ne fëmitë ma t'vegjël a po, ne kemi qenë t'parapagum në revista për fëmi në *Kekec* edhe *Zabavnik*. Aty... pse po e them këte? Prapë po e akcentoj për shkak se ajo ka qenë një formë e mirë e ngritjes që literatura shqipe e cila nuk ka ekzistru, nuk ka siguru një ngritje normale të fëmiut apo ma vonë domethënë arsimimit e kshtu me radhë. Dhe pas, për shembull ka pasë bibliotekë shumë aktive, jashtzakonisht aktive në Mitrovicë që unë shumë... shumë bukur m'kujtohet që e kom frekuentu dhe që kom lexu libra në serbishte. Ja, domethënë ai ambient e ka ba, të them specifikë këtë, domethënë atë zhvillimin tim dhe do t'thoshja dhe Mitrovica si, si shoqëri osht' ni vend mjaft i dallushëm prej qyteteve tjera. Kur e shof tash nga kjo perspektivë mu më duket që mjaft mirë ka lujt rol pozitiv, domethënë, a, në ngritjen edhe time t'mavonshme.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me identifiku prej nga ai interesim i babait për arsimim?

Rafet Rudi: Po, qe kshtu, s'pari po them t'ju them se babai im... unë nuk e njof. Ai ka vdekë kur unë kom qenë katër vjeç. Domethënë, ne kemi qenë si familje t'lidhur me, me nanën, ni personalitet i jashtzakonshëm mund t'them a, osht' çuditshëm. Po e akcentoj këte për shkak se thonë se babai im paska qenë mjaft i qetë, jashtzakonisht i qetë. Domethënë i rregullt e, i... kshtu me radhë, kurse nana ka qenë shumë dinamike, dinamike energjike dhe ajo e ka bo në të vërtetë që ne të, të ngritemi domethënë të arsimohemi a po, kshtu.

E tash, po e them këte, ndikimin domethënë të madh në muzikë, unë e kam nga vllau Reshadi, i cili është ekonomist, ka qenë, po i takon një gjenerate të tërë intelektualësh studentësh, a po, që kanë studju në Beograd. Kjo është domethënë, dihet mirëfilli a po. Viti? Kjo e kap, i kap vitet diku fundi i viteve '50-ta, vitet '60-ta dhe ka pasë me qinda studentë shqiptarë, dhe ata studentë, tash studentët që kanë qenë të lidhur me Mitrovicë a po. Ndër ta edhe vllau im edhe motra ime, kur jonë kthy në mujt

e pushimit a po, ata kanë zhvillu do aktivitete domethënë ato kanë qenë tubime ndeja, ndeja të rinjve që kanë qenë, mund t'them, për atë kohë më t'emancipum a po, domethënë se shtresa tjetër në qytet.

Dhe ata i kanë pasë ato takimet domethënë, ne tash i qujmë ndryshe apo *party* e kshu me radhë, a po? Ata janë taku dhe kanë këndu dhe këto kanë qenë parreshtur a po, një herë n'javë, domethënë janë taku kjo strukturë e njerzve. Dhe unë si i vogël domethënë kom fillu, domethënë t'i përcjelli ato dhe të ndihmoj me kitarë. Shumë interesant, domethënë instrumenti i parë që me të cilin jom lidhë ka qenë kitara. Natyrisht se ajo ka qenë krejtsisht kshu amatore, domethënë ajo ka qenë një përcjellje e këndimit shumë t'thjeshtë, por e këndimit a po, dhe domethënë aktivitetit muzikor dhe këngët që janë këndu kanë qenë këngë të muzikës, të zhanrit t'muzikës zbavitëse a po, për atë kohë. Domethënë, jo tubime folklorike, s'kanë qenë a po. Këto tash ne nuk i vërejmë dallimet, por n'atë kohë ato dallimet janë dukë mjaft të ashpra a po, janë dukë, dhe pikërisht domethënë në këtë ambient kanë qenë ato kontaktet e mia me, me muzikë.

Mandej ata kanë pasë një entuziazëm natyrisht për shkak të asaj që janë që, t'ambientit ku kanë jetu, se ata kanë qenë në, domethënë ka lind veç... që vllau im ka qenë aktiv edhe në shoqatën "Përpjekja" të Beogradit a po, dhe Beogradi sikurse dhe Zagrebi a po, dy qendra që në të cilat ka pasë studentë ma tepër shqiptarë a po, ato kanë qenë qendra relativisht të, të zhvillume. Bile, unë mendoj që shumë të zhvillume nëse, nëse kihet parasysh sistemi n'cilin ne kemi jetu, a po. Domethënë, ai ka qenë nominalisht sistem komunist a po. Por, siç dihet n'bllokun e lindjes, Jugosllavia ka qenë shumë përpara dhe krejt ajo ka bo që ndikimet t'jenë të mdhaja, domethënë në ambientin tonë kulturor përmes ktyre studentve që kanë qenë në këto qendra. Dhe kshu, unë i takoj pikërisht këtij ambienti a po, dhe këto kanë qenë ato, e po e përsëris, ato kontaktet e para me muzikë, por jo dhe diçka ma, ma t'madhe jo diçka ma ambicioze.

Kontakti do t'thosha ndoshta esencial është ku në vitin '60-të kur kom fillu domethënë shkollën e muzikës, shkollën e ult t'muzikës e cila ka qenë në Mitrovicë, edhe kjo duhet shiqu në kontekstin e Kosovës. Mitrovica e ka pasë shkollën e muzikës përpos Prizrenit a po, edhe më dukët Prishtina n'atë kohë e ka pasë të hapur. Por, shkolla e muzikës e Mitrovicës ka qenë mjaft aktive specifike për shumë kshu karakteristika t'asaj dhe fillet, domethënë po them lidhen me këtë shkollë t'muzikës dhe me një, falë një aktiviteti që ka pasë profesori Fahri Beqiri. Ai ka qenë i ri n'atë kohë, por ka qenë një njeri mjaft dinamik, njeri komunikativ dhe ai ka mledh... me vite domethënë, këto, kjo, këtu flitet për '59, '60, '61 '62 a po, ku ka mledh talent fëmi të Mitrovicës dhe i ka orientu në muzikë. E meqë profesori Fahri ka qenë mik me vllaun e motrën time, që janë moshatar a po, ai domethënë ka insistu që të më teston për muzikë.

Dhe unë, m'kujtohet ai moment kur kom shku të, domethënë n'shollë t'muzikës dhe osht' dashtë të... natyrisht me ato format t'zakonshme të pytjes për testimin e veshit. Nuk, nuk e di tamon si është zhvillu, por e di diçka tjetër, se është dashtë t'deklarohem për instrument a po, dhe unë jom orientu në violinë. Natyrisht pa e ditë tamam se dallimin, ndoshta osht' shumë i madh në mes të violinës prej instrumenteve tjera e kshu, por kjo ka qenë dhe kshu ka fillu domethënë jeta ime me muzikë. Sigurisht nuk osht' fjala për ndonji ngritje shumë cilësore a po, se s'ka pasë profesionist n'atë kohë për instrumente, a po, në Mitrovicë. Sidoqoftë, ato informacionet apo atë kulturën themelore të muzikës e kom marrë pikërisht në shkollë t'muzikës, t'ult t'muzikës, dhe në njëfarë mënyre ajo ka qenë vendimtare pastaj edhe të vazhdoj shkollën e mesme në Prishtinë. Sigurisht ajo ka qenë për këte e randsishme, a.

Erëmirë Krasniqi: Kur keni ardhë në Prishtinë?

Petrit Çeku: Veç deshta një... edhe pak për Mitrovicën. Çfarë kujtimesh keni për pedagogët e muzikës, për profesorë atje?

Rafet Rudi: Shiqoni, po, po, shiqoni atë, atë kohë natyrisht nuk më kujtohen shumë të qartë, po... nuk, nuk e.... Për shembull, n'viti e parë kom mësu te Fahri Beqiri, kom mësu violinë. Ai nuk ka qenë violinist, nuk e ka pasë specialitet violinën a po, por aty në shkollë t'muzikës, këte e di sigurisht, kanë qenë të inkuadrum disa arsimtarë nga Vojvodina dhe edhe Serbia a po, kryesisht ata. Më dukët se ka qenë i vetmi Fahriu n'atë kohë a po, që ka fillu të punojë. Pastaj, natyrisht shkolla e muzikës e ka ndryshu këtë përbërje me vite, por n'fillim ato nuk kanë qenë, domethënë nuk kanë qenë muziktarë të... me specialitete të diferencume, a po. Domethënë, nuk është fjala për këtë nivel të arsimimit.

Erëmirë Krasniqi: A t'kalojmë në kohën kur keni ardhë në Prishtinë?

Rafet Rudi: Po, domethënë pas tri, pas tri vite, pas tri vite unë kom vazhdu shkollën e muzikës në Prishtinë. Osh t' interesant, m'vjen keq bile që nuk i kom rujt ato korrespondencat që kom pasë unë me vllaun e madh, i cili ka qenë në Beograd për shkak se nana ime ka, ka qenë, nuk ka qenë pro që unë t'shkoj jashtë Mitrovicës. Këtu du të bëhet e qartë se lëvizja Mitrovicë-Prishtinë ka qenë avanturë e tërë a po, domethënë nuk osh t' ajo si sot a po, dhe ajo natyrisht si nanë është frigu se unë n'atë moshë 14 vjeçare duhet të udhtoj. A mundeni me paraftyr se për provim pranues apo për vitin e parë të mësimimit, unë kam udhtu domethënë me tren prej Mitrovicës në Prishtinë, në Fushë Kosovë. Prej Fushë Kosovës në Prishtinë prapë me tren për t'mbri ta zamë n'mëngjes, a po, në msim. Kjo çdo ditë osh t' ba.

Petrit Çeku: Sa përafërsisht ka zgjatë udhëtimi?

Rafet Rudi: Po, ajo ta zamë sigurisht osh t' dashtë dy-tre orë para fillimit t'msimit a po, tri orë sigurisht a po, po supozoj, kurse siç dihet atëherë mësimi osh t' fillu shumë herët, a po. Unë nuk e di tamam, por sigurisht para tetve ose deri n'tetë jo si tash a po, dhe mund ta merrni me mend ni fëmi 14 vjeçar osh t' dashtë prej shtëpiu, shtëpisë në, te stacioni i trenit, ajo osh t' dashtë ta zamë diku n'ora pesë mund ta merrni me mend dimrit e kshtu. Bile, tash s'mund ta paraftyroj ate, domethënë që të, krejt kjo që të arrihet diku në mëngjes në mësim. Përgjithsisht, domethënë ka qenë një vështërsi, një avanturë domethënë vazhdimi i msimit jashtë vendit të lindjes a po, dhe nana ime ka pasë shumë rezerva. Por unë për çudi nuk e di edhe vet nga çfarë bindje, çfarë, çka ka qenë ajo që m'ka shty domethënë të insistoj që të shkoj dhe e kom pasë përkrahjen e vllaut tim i cili ka qenë në Beograd e me t'cilin osh t' dashtë të konsultohem.

E këtu po e përmendi këtë pjesë mjaft... motrën e vllaun për shkak se ne kemi diferencë dy-tremdhjetë vjet dhe ata kanë lujt rolin e prindit a po, prindit, kshtu. Mirë, domethënë kjo ka qenë, domethënë ky insistim i imi pastaj dakordimi i vllaut edhe motrës vendimtare që unë kom vazhdu në Mitrovicë. Mandej ka qenë edhe problemi edhe material, a po. Nuk ka qenë lehtë, domethënë shpenzime ka pasë një vazhdim i mësimimit jashtë ambientit ku kemi jetu, a po. Mirë, domethënë në Mitrovicë kom vazhdu mësimin domethënë shkollën, por e pranoj ajo kohë nuk ka qenë tepër produktive për n'kuptimin që, meqë unë për nga pregaditja kom pasë, kom qenë në nivel tjetër n'krahësim me shoktë edhe shoqet e klasës që s'kanë pasë pregatitje me shkollë t'muzikës n'atë kohë fare a po...

Erëmirë Krasniqi: Po flasim për Prishtinë a po?

Rafet Rudi: Prishtinë, për Prishtinë a po, osht' dashtë ma me ambicie t'them të, të, ta marrë ate. Nuk e shof që kom pasë ndoni, shumë ndoni ambicie, por do ta akc... do ta kisha akcentu këte se shkolla e muzikës n'atë kohë e Prishtinës ka pasë arsimtarë tërë... s'pari t'themi tërë msimi është zhvillu në gjuhën serbo-kroate dhe arsimtarët kanë qenë shumë të mirë. Kjo ka qenë mjaft e randsishme për zhvillimin tim të mavonshëm, absolutisht. Bile, unë kur e krahasoj me atë kohë klasa e tretë, katërt, ta zamë kur ne kemi shkrujt fuga të tërë, fuga të tërë, kur e krahasoj me zhillim shkollën e ma vonshme s'mund ta kuptoj nivelin që i ka ra shkollës t'muzikës a po, n'krahasim me atë kohë kur unë kom studju, kom mësu shkollën.

Domethënë, ka qenë një nivel i arsimtarëve relativisht i mirë, relativisht i mirë mos t'them shumë i mirë a po, dhe kjo ka qenë shumë e randsishme për zhvillimin tim se kanë qenë disa profesorë, nuk po i emërtoj tash nuk po i radhiti, që kanë nxitë në mu edhe disa kolegë që jemi dallu që të shkojmë edhe n'studime në Beograd a po, dhe pikërisht ato vitet e fundit viti i tretë e i katërt. Po them kanë, kanë qenë ma t'randsishme për zhvillimin tim n'kuptimin që unë nga pak kom fillu të vetëdijësohem për muzikë, për ate që mund t'jetë muzika e rëndsishtme për jetën time. Domethënë, si duket edhe pak ma ambicioz kom qenë n'atë kohë, dhe qysh në vitin e katërt unë kam fillu më konkretisht në ndikimin e këtyre arsimtarëve t'mirë që kanë qenë nga Nishi, nga Beogradi e kshtu me radhë, të mendoj për studimet dhe për vazhdimin e studimeve në Beograd. Kjo, prapë edhe kjo është, duhet të kihet paraysh se ajo kohë ka qenë e tillë që me shkollë t'muzikës ti ke gjetë menjherë mundësinë e punësimit, domethënë dhe...

Petrit Çeku: Në shkollë të muzikës?

Rafet Rudi: Po, n'shkollë t'muzikës, që sot besoj që s'osht' fare e mundshme apo dhe atë... domethënë, se a do t'vazhdoj në studime ajo ka qenë, osht' dashtë të tregosh një, një kshtu, një dashuri ma t'madhe, një ambicie ma t'madhe a po, për shkak se e ke pasë variantën tjetër të zhvillimit apo t'jetës në një nivel tjetër të punsimit dhe kshtu me radhë, a po. Dhe, natyrisht unë nuk kom pasë atë dilemë, megjithë që në, para... Domethënë, shkollë... akademinë dhe studimet nuk i kom vazhdu menjherë me mbarimin e shkollës t'muzikës, por pasi që, pas mbarimit unë kam vazhdu të punoj një vit në shkollë t'muzikës si përgatitje për Beograd, domethënë për studimet në Beograd, dhe domethënë unë jom përgatitë me plot kuptimin e fjalës.

Natyrisht jo me dikend, vetë a po, vet jom përgadit. Por, të them informacione se çka kërkohët, çfarë kërkese jonë për provim pranus, unë i kom pasë edhe përmes arsimtarëve dhe përmes prapë profesorit Fahri, i cili atë kohë domethënë i pat' mbaru studimet në, në Beograd dhe domethënë kur kom shku në Beograd, unë veprat e mija, jom ul n'piano i kom ra, a po. Dhe kjo ka qenë forma e prezentimit edhe domethënë audicionit a po, për studime. Osht' kjo e randsishme se unë qe i kom lujt, si dukët edhe ai ni prej elementeve ka qenë që ata edhe më kanë pranu në Beograd. Domethënë...

Erëmirë Krasniqi: N'përgjithsi ky edukim muzikor a ka qenë krejtisht i ri pas Luftës së dytë botrore, a jonë edukuku me këto rryma muzikore njerzit përpara?

Rafet Rudi: Në shkollë? N'shkollë t'muzikës?

Erëmirë Krasniqi: Po... në këto rryma?

Rafet Rudi: Domethënë, ka qenë shkolla e muzikës në Prizren a po, që ka qenë domethënë një formë, një çerdhe e zhvillimit të muzikës klasike. Në Mitrovicë ka qenë e dyta dhe ma vonë a po, në vitin '61 edhe shkolla e muzikës në Prishtinë shkolla e mesme e muzikës. Nuk mund të flitet për nivel t'madh domethënë nuk, nuk është fjala këtu për jetë muzikore, domethënë jetë koncertale, a po. Domethënë ky është ni, ni nivel relativisht i ult i shk... i arsimimit a po, por osht' shumë domethënës për shkak se ajo ka qenë shkollë specifike jashtë gjimnazit domethënë, dhe po supozoj që ajo... pikërisht ky element ka bo t'rëndsishtme edhe ngritjen e kuadrove, se ai që ka shku n'shollë të muzikës normalisht ai më, ai që ka qenë më ambicioz apo domethënë më i talentum, a po, ai ka mendu vetëm për ngritje dhe t'mëtuftjeshme. Ajo ngritje e matutjeshme ka nënkuptu akademinë, a po, e muzikës. Por, të them edhe këte se në shkollë të muzikës këtu, e ceka, ka pasë disa arsimtarë një nivel jo edhe aq i vogël, a. Për shembull, mu m'kujtohet në shkollë t'muzikës në sallën që deri vonë ka qenë apo n'këtë ndërtesën e shkollës këtu t'muzikës, ka pasë prova orkestra simfonike, një lloj e orkestrës simfonike, a po.

Mu m'kujtohet taman që kom qenë prezent, ka qenë një familje e Nishit bile vajza e tyre është një çeliste tash e njoftur në Gjermani, Ksenia Jankovic. Domethënë, ajo ka qenë femi, domethënë, ajo ka qenë nxanëse. Kurse Olga Jankovic ka qenë pijaniste, Pavli Jankovic ka qenë dirigjent dhe ata kanë zhvillu njëfarë aktiviteti, a po. Po, s'di për çfarë, me çfarë ambicie me çfarë domethënë qëllimi, por ata kanë zhvillu dhe kjo ka qenë shumë e randsishtme për ne nxanësit. Unë m'kujtohet kur kom qenë n'prova domethënë të orkestrës simfonike. Po e them se ato janë, të them momentet e para të kontaktit me muzikën profesionale, pak ma profesionale se që... n'krahësim me ate që ka qenë ma parë a po, që supozoj, supozoj që në atë kohë as Prizreni nuk ka mundur ta ketë këtë. Këtu po flas për vitet, do të thotë '64, '65, '66, '67, a po.

Për një moment, ju edhe e dini historikisht besoj se domethënë në fillim menjëherë pas luftës qendër ka qenë Prizreni dhe pastaj osht' bartë. Si qendër administrative osht' bo Prishtina dhe rrjedhimisht kësaj kanë fillu edhe institucionet a po. Domethënë, ka fillu radioja, Radio Prishtina, n'kuadër të Radio Prishtinës ka pasë disa aktivitete, disa kshu aktivitete kolektive, kori i radios ni formë amatore ka punu, mandej orkestra ka punu. Dhe me këtë bartje, domethënë të zhvendosjes së qendrës nga Prizreni në Prishtinë i ka pasë ato reperkusionet e veta n'kuptimin se, domethënë muziktarët tanë të parë kanë dalë në Prishtinë. Ta zamë Rexho Mulliqi, Lorenz Antoni kanë vepru atje dhe pastaj janë bartë në Prishtinë. Dhe për këtë kohë që po flasim, për shkollë t'muzikës në njëfarë mënyre Prishtina ka fillu të bëhet qendër muzikore, jo më Prizreni, e jo edhe Mitrovica, a po... Kjo është e randsishtme domethënë të ndriçohet ajo periudhë.

Petrit Çeku: N'vitin e tretë dhe katërt të shkollës t'mesme e keni ngritë entuziazmin për muzikë e për...Deshta me t'pytë a keni pasë qasje n'muzikë edhe në çfarë forme, n'kuptimin e dëgjimit t'muzikës?

Rafet Rudi: Po, natyrisht, kanë qenë shumë, shumë t'pakta, shumë t'pakta a po. Domethënë, po flasim për shkollën e domethënë për një periudhë e zhvillimit të kësaj shkolle edhe shkollave tona, kur, t'them pak edhe një, domethënë një para... jo, një kshu përshkrim të situatës politike, a po. Ajo ka qenë një, një kohë mjaft e vështirë për shqiptarët a po, dhe ajo... ato kanë qenë vitet e fundit të një, të një regjimi mjaft të ashpër ndaj arsimit, kulturës shqiptare e kshu me radhë të asaj kohe. Ato, ato që ka pasë... ato ndryshime, ato kanë qenë ma tepër kshu për efekte t'jashtme politike a po, por n'esencë ka qenë shumë pak, ka pasë ngjarje muzikore a po, ngjarje muzikore. Aty mund t'ketë pasë,

ato që mu më kujtohen është ato kontaktet që kemi pasë me shkolla simotra, ta zamë në vende të ndryshme nëpër Jugosllavi.

Për shembull, mu m'kujtohet shumë mirë kur kemi qenë, ta zamë me shkollë t'muzikës në Beograd ose ndonji shkollë e muzikës e Nishit, Beogradit ka pasë koncerte n... në shkollë tonë të muzikës. Këto kanë qenë forma, a. Mandej kanë qenë edhe ndonji koncert sporadik. Për shembull, m'kujtohet kalimthi meqë po flasim kështu për, folëm pak për kitarë, [Jovan] Jovicicin atëhere e kom pa n'shkollë të mesme të muzikës...

Petrit Çeku: Në Prishtinë?

Rafet Rudi: Po, po, në Prishtinë, në Prishtinë. Është shumë bukur kjo. Më kujtohet ai ka qenë këtu n'kinon e armatës n'atë kohë apo ku është, domethënë UNMIK-u ku ka qenë, e këtu n'këtë ndërtesë...

Petrit Çeku: A e din ti ku osht', po m'intereson?

Rafet Rudi: Kino, kino e armatës, te Grandi ajo qendra, qendra e UNMIK-ut që ka qenë... qendra, ndërtesa, jo, jo ndërtesa, ajo ndërtesë.

Petrit Çeku: Aha. E aty ka qenë kino e armatës?

Rafet Rudi: Po, kino. Ajo ka qenë një kino e zakonshme a po, por ka pasë disa salla dhe në një prej sallave domethënë ku ka ushtru edhe orkestra e armatës. Kjo osht' interesant. Atë kohë ka ekzistuar edhe konc... orkestra frymore e armatës se n'këto qendra, n'këto qendra domethënë si në Prishtinë, ta zamë Nish e kështu me radhë nuk i di ato organizimet ushtarake, por sipas gjitha gjasave Prishtina ka qenë një prej qendrave t'randsishme ushtarake dhe e ka pasë edhe këtë aspekt n'kuadër të saj. Mirë që e përmende, kjo është mjaft e randsishme, se zhvillimi i orkestrës simfonike lidhet me orkestrën e armatës. Domethënë...

Petrit Çeku: Në çfarë mënyre?

Rafet Rudi: Po, për shkak se s'pari dirigjenti i parë ka qenë i orkestrës simfonike të fl... po flasim për vitet '60-ta dikun a po, edhe '50 edhe '60-ta a po, ekziston një aktivitet i orkestrës simfonike që dokumentohet me inçizime që ekzistojnë sot në radio, a po. Dhe një prej njerëzve, ndoshta t'parët që e kanë zhvilluar këtë aktivitet ka qenë Vojnovic, ni Bogoljub Vojnovic, dhe ai ka qenë dirigjenti i orkestrës së... frymore në garnizonin e Prishtinës. Dhe detyrimisht ai, ata instrumentistë kanë qenë edhe ky dirigjenti kanë qenë pjesë e bërthamës së parë të orkestrës. Kjo osht' mjaft... kjo mund të dokumentohet këtu, a po... dhe pikërisht unë kur po them se ka pasë sporadike koncerte, dhe po supozoj që ka qenë edhe domethënë ndonji koncert apo domethënë ndonji aktivitet i kësaj orkestre, a po, frymore, frymore që ka mbledhë muziktarë nga vende të ndryshme, jo nga Kosova a po. Kanë qenë nga vende të tjera që... instrumentistë që kanë lëvizë. Ta zamë ai ka, ai ka mundur të jetë anëtar i orkestrës këtu, pas dy viteve ka mundur t'jetë i orkestrës në Nish apo Novi Sad e kështu me radhë.

[Rrëfimi vazhdon nga pjesa e parë e intervistës.]

Pjesa e Dytë

Rafet Rudi: Mirë, domethënë ne ishim dikun aty në... me orkestrën e spjegum a po? Mendoj që në qoftëse është regjistru krejt nuk ka diçka ma t'madhe, për shkak se ndryshimi esencial ka qenë disa vite ma vonë. Se unë '67-tën, '66, '67 i kom mbaru shkollën e mesme dhe atëherë ka qenë ai, "Plenumi" i famshëm i katërt i Brioneve, a po? Dhe aty është dall... aty është një ndryshim esencial, dhe shumë drastik {thekson me gisht tregues}, drastik. Domethënë, drastik edhe për këtë, edhe për mentalitet për këte që u mundova ta spjegoj përpara që ti ki... e ki pa Beogradin e kshtu, kurse domethënë '66-shën, '67-shën, në '68-tën jonë ato ndryshimet amandamentet a po, t'njoftuna këta politikanët i dinë, dhe mandej që ka çu deri në '74-tën në krijimin e Kushtetutës, a po. Kjo është... momente decizive. E këtu duhët me spjegu domethënë këtë periudhë, por unë në këtë periudhë unë kom qenë në Beograd a po, a po, prej '68-shës deri në '7... praktikisht në '74-shën unë kom qenë... '73-shin nandor-dhetor a po, domethënë '74-shën unë kom qenë në Beograd a po. Mirë...

Petrit Çeku: A mund të flasësh pak edhe për Beogradin?

Rafet Rudi: Po, edhe Beogradin po, kjo është, kjo është e randsishme a po. Natyrisht, është e randsishme posaqërisht për mu, për zhvillimin, a po.

Petrit Çeku: Si ka qenë kuadri i akademisë?

Rafet Rudi: Kshtu, domethënë '60... në vitin '68, '69 une regjistroj studimet në Beograd, në degën e kompozimit. M'kujtohët natyrisht që kom shku në provim pranues. Mjaft, mjaft, bile tash më dukët çuditshëm, mjaft i bindun, shumë... se do t'jetë me sukses. Ndonëse ajo ka qenë një, një ambient relativisht i mbyllun për shqiptarët a po, për zhvillimin e tyre sidomos për drejtimet specifike. Se student në Beograd në akademi ka pasë, por kryesisht kanë qenë të drejtimit pedagogjik, a po. Esat Rizvanolli është i pari që ka qenë edhe Fahri Beqiri me... të orientum në drejtimin e kompozicionit a po. Dhe domethënë n'atë kohë dhe unë kom shku, dhe unë i kom ra kompozimet e mia n'piano, dhe ata kanë vlersu që kjo mjafton dhe jom pranue. Dhe ky, ky moment osht' jashtzakonisht domethënës, për shkak se ndryshimi ka qenë i jashtzakonshëm. Ndryshimi i ambientit, dallimi shumë i madh i Prishtinës dhe Beogradit në kohë, n'atë kohë. Tmerrsisht ndryshim i madh. Derisa këtu nuk ka pasë domethënë aktivitete konstante a po, atje ka qenë një jetë domethënë kulturore, kulturore po e akcentoj për shkak se posaqërisht unë kom qenë i interesum edhe për fusha të tjera a po, po këte për një moment po e lamë pa e shtjellu shumë.

Po kthehemi te muzika, domethënë kanë qenë shumë, ky n... ndryshim shumë i madh dhe shumë deciziv për zhvillimin tim, për shkak se ta zamë n'vitin e parë une kom pa një, një gjigant Genadio Rozdevstvenski për shembull, një... orkestra të mdhaja shumë kualitative, dhe jeta muzikore në Beogradin e asaj kohe ka qenë shumë ma e zhvillume se në Beogradin e ditve t'sotme. Nëse e keni parasysh frekuentimin e ansambleve, formacioneve kamertale, orkestrave dhe emrave të mdhej a po. Domethënë, mund t'them se në bllokun e lindjes a po, ajo dihet historikisht nuk lidhet me, me ne, nuk është diçka që unë po e them këte domethënë si, si diçka t're.

Sigurisht Beogradi ka qenë domethënë qendra kryesore kulturore e bllokut të lindjës. Për shkak se, vetëm po e spjegoj në një plan ma të gjërë, orkestrat kanë qenë të interesume të shkojnë në bllokun e lindjës, po me vështërsi ata kanë shku në, ta zamë Sofje e n'qendra tjera a po, kurse në Beograd frekuentimi ka qenë shumë i madh. Kur po them Beograd duhet t'th... meniherë e cekë se zakonisht kur kanë ardhë artistët, emrat, orkestrat e mdhej, orkestrat e mdhej ata kanë pasë koncert në

Beograd, Zagreb edhe Lubljanë a po. Ky osht' ni, ni kshtu detal i vogël a po, por i randsishëm.

Ajo që për mu ka qenë shumë punë e madhe, është se unë përfundimisht jom l... lidhë me muzikën klasike se n'ambientin e këtushëm të Kosovës unë kom zhvillu ni lloj aktiviteti dhe n'fusha tjera bile të muzikës. Ta zamë kom qenë antar i grupeve, rok grupeve e kshtu me radhë, por në momentin kur, në vitin e parë kur kom kontakti domethënë ato emra aq të mdhej, për mu absolutisht ka qenë më... vetëm një rrugë jetësore ka qenë e hapur a po, ajo e muzikës klasike. Dhe, përgjithsisht domethënë ai nivel i madh që ka qenë në Beograd, nivel kulturor domethënë, nivel i lartë i zhvillimit të jetës koncertale ka qenë jashtëzakonisht domethanës për... domethanëse për ngritjen time.

Sa i përket profesorëve, duhet t'thënë se unë e kam mbrii atë gjeneratën e arsimtarëve, kompozitorëve, dirigjentëve serb a po, që kanë qenë t'them pak kshtu në perëndim, kanë qenë duke mbaru karrierën e tyre, a po. Qe po e përmendi disa, Oskar Danon ka qenë, Zivojinovic ka qenë, Mihovil Logar, ka qenë Zivkovic, Miloshevic e kshtu me radhë, dhe kjo është gjeneratë, në muzikën serbe, kjo njihët si gjeneratë e shkollës së Pragës. Domethënë, po e përmendi këtë detal, për shkak se Praga në vitet '20-ta, '30-ta ka qenë qendra kryesore e muzikës moderne. Ta zamë këta kanë qenë që kanë pësu, [jo] mësu shkollë te ni Jozef Su, te ni Alois Haba, domethënë kompozitor që, Alois Haba është konsideru një kompozitor modern jashtëzakonisht i madh viteve '20-ta, '30-ta, dhe këta kanë qenë nxanës të tyre dhe ate e kanë përçu, domethënë. Ata kanë studju dikun viteve '20-ta, '30-ta, a po, dhe kanë ardhë në Beograd. Dhe këto vitet kur unë kom fillu ata kanë qenë në perëndim, që po e them, kanë qenë në fund të karrierës së tyre por shumë e randsishme për mu ka qenë, a po, që kemi pasë domethënë në... njerëz të tillë që kanë jetu në jashtë, a po.

Në perëndim kanë qenë profesorë që kanë kry akademi shumë të randsishme në qendra, në Gjermani domethënë posaqërisht në Pragë, po e ceku, se n'mes dy luftrave. Nga ky blloku i lindjes Praga ka qenë qendra, për dallim nga Varshava, që ka qenë viteve '50-ta, '60-ta qendër e muzikës moderne, a po, në bllokun e lindjes. Domethënë, Beogradi ka dallu shumë në sistemin e arsimimit në kompozicion, nga ta zamë një qendër në Bukuresht apo në Sofje. Absolutisht ka qenë një qendër, domethënë, që ka kultivu një domethënë arsimim shumë t'avancum a po. Ta zamë në qoftëse osht' e randsishme në, në akademi të Beogradit ka ardhë Shostakovic, ka ardhë Stravinski, ka ardh Cage, Cage në '71-tën kur unë kom qenë në Beograd, Cage ka ardhë. Megjithëse, ai ka ardhë në "Bitef" a po, domethënë kjo është e randsishme, në "Bitef".

Petrit Çeku: Cka osht'?

Rafet Rudi: "Bitef" osht', ai është festival shumë domethënës i muz... i teatrit modern.

Petrit Çeku: A i teatrit?

Rafet Rudi: I teatrit. Ai ka ardhë, po {pohon me kokë} qysh dihet Cage ka qenë domethënë i shtri... i shtrirë t'them në shumë fusha, por pse po e ceku këte? Se Beogradi ka qenë një qytet krejtësisht i hapur, dhe meqë ka jetu domethënë Beogradi ka frymu në një ambient Jugosllav ku ka qenë edhe Zagrebi, në '61-shin e ke fillimin e Bialës së Zagrebit. Në '61-shin është Bialja e Zagrebit. Ato kanë qenë korresponduse këto qendrat, domethënë Beogradi, Zagrebi edhe... dhe domethënë Lubljana dhe t'them ato t'mirat e atij informacioni të bollshëm në fushën e muzikës moderne ke mundur aty me i gjetë, a po, domethënë në pikërisht në Beograd.

Në këtë kohë, sa i përket t'them jetës, domethënë zhvillimit tim a po, konkretisht në fushën e kompozimit, Beogradi ka qenë i lidhur dhe bashkëpjesmarrës në organizimin e festivalit në Opati. Tri... "Tribuna e krijimtarisë muzikore Jugosllave" që osht' një festival tejet domethënës për zhvillimin e krijimtarisë muzikore ktu në, domethënë në Kosovë për shkak se edhe ne kemi qenë ma vonë a po, disa vite ma vonë tërë kohën të lidhur me atë festival. Ai ka qenë një festival jashtzakonisht modern, jashtzakonisht a po, domethënë të gjitha tendencat aktuale që u zhvilluan në vendet tjera, në qendrat tjera në Amsterdam, Londër, apo domethënë Koln, apo Damstadt apo dikun tjetër ato kanë pasë jehonë pikërisht në, në "Tribunën e krijimtarisë muzikore Jugosllave" dhe natyrisht edhe në Bialen e Zagrebit, siç dihet historikisht a po, dhe kjo ka qenë....

Po e ceku këte për shkak se që nga viti i parë unë, ne në në akademinë tonë, domethënë ka pasë organizim që studentët e kompozimit të dërgohen në festival. Domethënë, ni javë osht', katër-pesë ditë ka zgjatë festivali. Dhe ai ka qenë festival që, në të cilin osht' prezentu i gjithë potenciali më i mirë i krijimtarisë dhe i artistëve reproduktiv të asaj, të qendrave Jugosllave, a po. Dhe ta zamë që në vitin e parë unë kom qenë i rregullt në atë festival dhe pastaj ai festival në njëzet vjetshin e ardhshëm, t'them (qeshet) ka qenë domethënës, dhe ka qenë tanë kohën me ndikim ma të madh a po, domethënë masiv të them në krijimtarinë time dhe n'krijimtarinë e disa prej kompozitorve tanë të... që kanë qenë t'interesum t'jenë pjesmarrës. Dhe përkundër që ajo ka, domethënë osht' zhvillu krejt në anën tjetër të Jugosllavisë ajo ka qenë sh... ka një rol sh... domethënës në pamjen e krijimtarisë tonë të viteve, t'fillimit të viteve '70-ta.

Domethënë, partiturat që ju mund t'i shifni të kompozitorëve t'paktë tonë, osht' e vërtetë a po, t'paktë tonë, ato jonë relativisht korrespondente me krijimtarinë që osht' zhvillu jo vetëm në Beograd, në Zagreb, po edhe dikun ma gjërë, a po. Mandej, ajo kohë, duhet spjegu edhe këtë detaj. Ne kemi qarkullu, ne kemi lëvizë. Ta zamë ne kemi udhtu, n'krahësim me kolegët tanë ta zamë në Sofje, kolegët tanë ta zamë në Rumuni apo kshtu, domethënë këto vendet e lindjes. Ne kemi pasë, ta zamë unë viteve '70-ta kom shku edhe në festivalet botrore, a po.

Petrit Çeku: Kur thuni ne si akademi, domethënë si studentët e akademisë a po?

Rafet Rudi: Akade... po, po studentët e akademisë.

Petrit Çeku: Akademia ka pasur udhtime të organizume?

Rafet Rudi: Po... po po, studentët e akademisë drejtimi i kompozimit ka... në mënyrë t'organizume kemi shku në atje, në festival. Domethënë, "Tribuna e krijimtarisë muzikore Jugosllave" dhe në Bialen e Zagrebit ndonji vit, po ajo ka qenë Bienale. Domethënë kjo, kjo domethënë ky ambient krejtsisht i hapur i Beogradit ka qenë shumë ndikues apo vendimtar për orientimin tim, domethënë në krijimtari. Mandej kalimthi n'qofse përqëndrohemi tash në zhvillimin tim, unë pas një viti të studimeve në degën e kompozimit, unë e kom regjistru edhe degën e dirigjimit, që osht' krejtsisht dy degë të ndara a po. Bile sa për informacion unë pasi... ma parë kom diplomu në dirigjim edhe ni vit më vonë kom, kom kry studimet e kompozimit a po.

Qe kshtu, mandej domethënë unë mendoj që ajo ka qenë e randsishme ndoshta të për... osht' e randsishme ndoshta të përmendet që unë kur kom shku n'Beograd unë e kom zotëru gjuhën serbe. Unë nuk kom pasë kurrfarë pengese menjherë të hyj në, t'them ta përjetoj jetën kulturore a po. Domethënë, nuk kom pasë kurrfarë barriere, a po.

Petrit Çeku: Për shkak të librave...

Rafet Rudi: Po. Po, domethënë për ate që e përmenda ma parë se në Mitrovicë osht' ditë, prej neve shqiptarve osht' ditë gjuha serbe, dhe unë kom qenë i, mjaft kshtu i pasionum për libër dhe domethënë literatura ka qenë një, një kshtu ni fushë që jashtzakonisht tërhekëse ka qenë për mu jashtzakonisht, domethënë, e randsishme për mu dhe për zhvillimin tim. T'them, unë e kom përjetu mjaft intenzivisht atë jetën kulturore. E përmenda jetën kulturore në Beograd se m'kujtohet ta zamë si student sigurisht ka pasë shumë teatro. Ta zamë sigurisht nja pesë-gjashtë teatro profesioniste kanë qenë, të profilizume, a po, dhe sigurisht s'ka pasë shfaqje që unë brenda sezonës nuk e kom pa. Praktikisht t'gjitha. Domethënë, absolutisht mund t'them a po, sa i përket teatrit. Mandej ka pasë botime. Natyrisht edhe këtu {tregon me dorë kah biblioteka} kom botime të shumta të asaj kohe, botime në fushën e teorisë së muzikës që ato vetëm në në s... gjuhën serbo-kroate kemi mundur t'i, t'i kemi dhe ka qenë shumë e randsishme zotrimi i gjuhës, niveli i njohjes a po. Ka qenë edhe unë e kom, domethënë e kom... në një mënyrë domethënë t'plotë e kom përjetu ato pesë vite që kom qenë në Beograd dhe natyrisht aty të them në njifarë mënyre jom profilu a po.

Niveli përgjithsisht në arsimim ka qenë i lartë, në kuptimin e jo eksperimentimit. Domethënë ek... arsimimi në fushën e kompozimit osht' e vërtetë që ka qenë ma tepër i bazum në muzikën domethënë neoklasike kushtimisht t'them prej ktyre profesorve që i përmenda ma parë, a po. Domethënë, por ajo e ka një të mirë se jonë mësu landët teorike bazike. Pa eksperimentime, a po. Domethënë, harmoni osht' mësu n'nivel t'lartë, analiza osht' mësu në nivel t'lartë, domethënë harmonia, polifonia. Kërkesat në piano kanë qenë shumë të larta, a po, që ta zamë unë kom pasë ambicie domethënë edhe pianon ta regjistroj. Ndoshta dhe për faktin se profesori im ka qenë njikohësisht dirigjent i operës së Beogradit, gjatë karrierës së tij ka qenë kompozitor, dhe ka qenë pianist. Bile aq sa edhe me orkestrën filharmonike të Çekisë ka qenë solist a po, dhe ndoshta për ate dhe unë e kom pasë këtë ambicie që t'gjitha këto fusha t'i përmbledhi në zhvillimin tim dhe ato, t'them përgjigje, kanë mundur të japin... të gjejnë natyrisht n'atë ambient të Beogradit të atëhershëm.

Ne kemi pasë, domethënë, osht' e randsishme ndoshta të thuhet që ne studentët edhe paraardhësit e mi, domethënë kolegët ma t'vjetër Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri a po, po flas për kta të drejtimin t'kompozicionit, kemi pasur një ndihmesë kshtu njerëzore prej profesorve tanë, edhe prej... unë prej profesorit tim a po. Nuk ka pasë ndonji rezervë a po, domethënë ka qenë relacioni jashtzakonisht njerëzor a po. Ndonëse po supozoj që n'atë Beogradin, në gjërsinë [e tij] ke mundur gjithçka të gjesh a po, edhe domethënë anët e qjija, por gjithsesi jo ai Beograd që ma vonë osht' zhvillu a po, domethënë i ashpër, tepër i ashpër ndaj shqiptarëve dhe armiqtësor ndaj shqiptarve e kshtu me radhë.

Duhet thënë se këto vite përkojnë me një ndryshim esencial në botën e... politike të Kosovës, dhe doemos ajo ka pasë ndikim në, në edhe në raportin që ne kemi pasë, studentët e Beogradit nga profesorët tanë, a po. Raport t'them mjaft kor... mjaft korrekt a po. Ju ndoshta dhe... ndoshta dhe këte duhet t'thënë, sa kom qenë unë në, në Beograd këtu ka fillu dhe formi... procedura e formimit të Shoqatës së Kompozitorve të Kosovës, që osht' bo pikërisht me ndihmën e, e profesorëve tanë të Beogradit a po. Kshtu si fakt historik.

Petrit Çeku: A ka qenë edhe ajo e lidhur me Shoqatën e Kompozitorëve të Jugosllavisë?

Rafet Rudi: Po, po, dhe me Shoqatën e Kompozitorve të Serbisë, në kuadër të Lidhjes së

Kompozitorve të Jugosllavisë. Domethënë, t'gjitha, domethënë Republikat i kanë pasë Shoqatat e veta të Kompozitorve që kanë zhvillu një aktivitet jashtzakonisht të madh a po, me, në fushën e botimit, në fushën e domethënë komunikimit që kanë pasë me shoqata të ngjajshme në botë. Kjo është shumë e randsishme. Ta zamë n'atë kohë si, me të përfunduar të, të studimet, unë kom marrë pjesë zyrtarisht si kompozitor në mbrëmjet e Bratisllavës. Një festival a po, "Mbramjet Muzikore të Bratisllaves". Osh't' ni festival që edhe sot ekziston, festival i muzikës moderne dhe ne e kemi shfrytëzu atë lidhje që ka ekzistuar mes kompozitorve Jugosllav dhe shoqatave tjera. Domethënë, Shoqata e Kompozitorve në '69-shën ka fillu të bëhet si degë e Shoqatës së Sërbisë, kurse '72-shën osht' formu edhe si, si shoqatë e pavarur pikërisht me ndihmën e këtyre domethënë muziktarëve që unë i përmenda a po.

Petrit Çeku: Kam kuriozitet personal, në fakt kërkesë personale, nëse mundeni m'i përmend disa prej emrave të mdhaja muzikore që i kemi dëgju në Beograd, po du m'i pasë t'regjistrume.

Rafet Rudi: A, po. Domethënë, po, domethënë në Beograd kanë frekuentu emra jashtzakonisht të mëdhej të bot... emra botror të artit muzikor, domethënë qoftë reproduktiv, qoftë kompozitor a po. Ta zamë, nga kompozitorët në Beograd, jo në periudhën që unë kom qenë, por përgjithsisht në atë kohë a po, në vitet '60-ta, '70-ta, kur ne kemi studju domethënë edhe ko... edhe kolegët tjerë, kanë qenë Shostakovic, ka qenë domethënë Stravinski, Darius Mijo e kshtu me radhë. Ka qenë John Cage, i cili ka ardhë domethënë me rastin e një festivali të teatrove Bitef-it, por ka ardhë për shkak se ka pasë interes ai mes [mjedis] për një kompozitor aq t'randsishëm eksperimentalist a po, emër botëror a po. N'anën tjetër, artistët, orkestrat kanë qenë vazhdimisht prezente, të Vjenës, ta zamë kanë qenë të Zvicrës, orkestra Italiane. Prej emrave ta zamë ka qenë ni Zubin Mehta, Horenstein ka qenë, tash çka m'kujtohet ka qenë Filharmonia e Berlinit me [Herbert von] Karajanin me dy koncerte a po, që po e përmendi se kanë qenë koncerte që jashtzakonisht kanë pasë jehonë të madhe dhe rëndsi domethënë për mu por edhe për, gjithsesi për ambientin, por për mu si muziktar.

[Rrëfimi vazhdon nga pjesa e dytë]

Pjesa e Tretë

Petrit Çeku: Po, si kanë qenë t'randsishëm këta emra që i përmendët për shembull?

Rafet Rudi: Ah, po. Domethënë, domethënë për zhvillimin tim këta emra që i përmenda ta zamë ka qenë edhe emra si Mravinsky, Davidostira e kshtu me radhë, që kanë qenë prezent n'jetën kulturore të Beogradit. Ato kanë qenë jashtzakonisht të randsishme n'kuptimin e, domethënë ngritjes natyrisht t'nivelit tim si artist, por edhe lidhjes ma t'madhe t'them me muzikën. Se unë shpesh edhe studentëve ma vonë ju kom spjegu se sa është e randsishme jeta muzikore për zhvillimin e artistit. Nuk është vetëm shkolla. Bile mund t'them se ajo pjesa tjetër osht' edhe, ndoshta edhe ma e randsishme a po, dhe rrjedhimisht ksaj... osht' ni detaj, se unë në Beograd... nuk më ka bënë lidhjen e madhe dëgjimi i një orkestrës t'filharmonisë të Beogradit, apo radio orkestrës, por orkestra si Filharmonia e Berlinit. Aty, ajo ka qenë {spjeguon duke bashkuar duart me njëra tjetrën} vendimtare domethënë në zhvillimin tim, për shkak se për një artist shumë osht' e randsishme domethënë përjetimi i ngjarjeve të mdhaja. Ato e bëjnë decizive domethënë kalimin në një stad tjetër. Jo, jo, orkestrat mesatare t'them a po. Këte shpesh unë studentëve ju them që osht' mirë shumë të shkoni në orkestra, koncerte t'orkestrës tonë, vetëm duhet ta dini që orkestrat tjera, domethënë botrore, tingllojnë mjaft ndryshe, a po, që ata nuk i përjetojnë këtu a, mjerisht a po, dhe atyre ju mbet nëse dëshirojnë zhvillim të madh, të kontaktojnë

ngjarje të mdhaja. Orkestra të mdhaja, artistë të mdhej, e kshtu me radhë a po.

Petrit Çeku: A mundëni, pak disi shkurt me spjegu. Sigurisht që estetika e juv muzikore apo qasja në art ka ndryshu gjatë qëndrimit në Beograd, a mundeni me spjegu shkurtimisht se n'çfarë mënyre osht', çfarë estetike përafërsisht artistike keni pasë në atë kohë?

Rafet Rudi: Po, interesant ndoshta, ndoshta dhe ndoshta po e elaboroj pak ma n'mënyrë ma precize. Profesori tek i cili unë kom mësu, që unë e kom domethënë respektu, adhuru e kshtu me radhë, domethënë ka pasë një njohje megjithate, tash ma vonë e shof që ka pa një njohje t'kufizume. Domethënë, ai ka qenë i përqëndrum në një, në orientimin neo... neoklasik a po, kurse ambiciet e mia kanë qenë pak ma t'mdhaja a po, që nuk kam mundur të kem përgjigje direkt te ai. Natyrisht përkundër atij, atë ndjenjën domethënë prindrore që e kom pasë prej tij dhe gjithmonë jom domethënë falënderues për këte. Unë e përmenda aspektin pozitiv të këtij orientimi të Beogradit a po, të akademisë së Beogradit, por ekziston edhe një detal, një anë tjetër. Ate që kemi ndëgju, ta zamë në festivalin e Opatisë, t'krijimtarisë muzikore Jugosllave, ajo ka qenë një orientim... [cingron telefoni] ...ndoshta vetëm e nalni, n'qofse... vetëm e nalë (qeshet).

Petrit Çeku: Po, pastaj, Opatisë...

Rafet Rudi: Po. Domethënë, s'po di ku mbetëm, por hajde po e, edhe një herë po e... domethënë ai orientim në Beograd që ka qenë kryesisht domethënë i orientum ka ni neoklasicizëm a po, domethënë ka qenë domethënë megjithate i kufizum. Ate që kemi ndëgju ta zamë në festivalin e krijimtarisë muzikore Jugosllave ku kanë frekuentu orkestrat të Zagrebit, të Lubljanës e kshtu me radhë, ka dallu. Domethënë, ajo ka qenë një nivel pak më i avancum. Shumë ma, shumë ma kshtu ambicioz në orientimin stilistik të, të veprave që jonë prezentu, a po. Dhe ato pesë vite përfundimisht kanë rezultu me simfoninë time a po, që osht' ni frymë neoklasike e bazume diku në Prokofievin, Shostakovicin e kshtu me radhë. Ajo k... kjo, këtë vepër që e përmenda osht' e randsishme se unë me atë vepër pikërisht në atë kohë në përfundim të studimeve, unë kom fitu një sh... çmim t'madh federativ atëherë, në një konkurs anonim a po, për këtë vepër, dhe ajo ka qenë mjaft e randsishme mandej për vazhdimin tim t'jetës si muziktar në Prishtinë, se i kom, disa benefite i kom pasë pikërisht për shkak t'atij, domethënë atij çmimi.

Mirë, po kthehemi edhe në, në orientimin t'them stilistik a po. Ambiciet e mija kanë qenë në vitet e fundit, vitet e katërt, pestë, më të mdhaja më shumë se sa që Beogradi ka mundur t'i ofron. Kjo osht', kjo osht' shumë e randsishme dhe kjo dëshmohet menjëherë me vip... me veprat e mija një vit, dy vite ma vone, dy-tri vite ma vonë, që jonë ta zamë një kohë koncertante për piano orkestër të madh, që, ku unë përdori domethënë muzikën dodekafonike, muzikën seriale. Mandej veprat...

Petrit Çeku: Në veprën tuaj të parë e keni përdor teknikën e re, a po?

Rafet Rudi: Po, po në '75-shin, menjëherë pas studimeve. Praktikisht diçka që Beogradi nuk e ka siguru. Kjo është e randsishme a po. Mandej jonë disa vepra tjera, Metamorfoza për tre instrumente orkestër, harkor, "Rrojtja" për kitarë e orkestër, që jonë vepra atonale. Ato vepra nuk jonë shkrujt nga një bagazh t'them i Beogradit. Dikun n'fundament sigurisht po, a po, për shkak se arsimimi kam, e ka leju ate, po për atë orientimin tim të ri t'them në muzikën, kushtimisht thënë, avangarde a po, t'asaj kohe ajo domethënë është ushqy jashtë Beogradit. Tash duhet t'thuhët edhe ky aspekt tjetër a po, përkundër ato t'them admirimit që kam unë për ato vitet e studimit, studimit, domethënë ato

megjithate Beogradi ka qenë domethënë relativisht kufizus a po. Por, fakti që unë kam mundur të udhtoj, ta zamë në “Vjeshtën e Varshavës” kom shku n’ato kohë dy vite, ku partitura, partiturat më, mos t’them ekstreme, po ma avansuse të muzikës moderne, i kom siguru nga atje të kompozitorëve si Lutoslawski, Penderecki, Seroski, Tadueusz Baird, ta zamë Górecki e ksht... kshtu me radhë.

Domethënë, une viteve ‘70-ta i kom i kom ditë krejt veprat e tyre. Bile, disa vepra kom qenë edhe prezent, disa vepra që ma vonë jonë bo t’famshme. Në premierë kom qenë a po, ta zamë “Mi Parti” osht’ ni vepër e Lutoslawski. Lutoslawski ka dirigju në ‘77-shën, unë kom qenë n’sallë domethënë e kom ndëgju edhe e kom diskun me atë vepër. Mandej Mayer e disa kompozitor. Domethënë kjo osht’ ni fushë krejtsisht e re nga Beogradi, a po. Shumë ma e avancume, dhe... por nuk, nuk e fajsoj Beogradin se pikrisht ai nivel i tillë i Beogradit që ka qenë, a po, ka mundësu pastaj unë të shkoj diku ma lartë n’qofse osht’ ajo ma lartë, a po. N’qofse mund të konsiderohët ajo orientim stilistik diçka vetëvetiu si, si domethënë, domethënë si rëndsi a, domethënë.

Unë n’atë kohë, natyrisht ma vonë unë i kom ndrru pikpamjet a po, mos ta komentoj këtë qëndrimin që unë sot e kom për atë muzikë, por është e randsishme domethënë që përgjithsisht kjo Kosovë me kthimin tim në ‘74-shën në Prishtinë, nuk kanë mbaru krejt t’them mundsitë për ngritje, për shkak se kemi pasë këtë komunikim shumë t’madh. Unë po... gjithmonë po e përmendi këtë komunikim, për shkak se për ngritjen e një krijusi, një kompozitori domethënë për dallim nga artisti reproduktiv a po, osht’ shumë e randsishme se a ka ai informacione për tendencat e reja. A po, domethënë kjo osht’, unë mund t’them se është vendimtare, a po, për shkak se muzika domethënë kompozitori duhet t’jetë aktual. Duhet t’jetë domethënë korrespondent me ate çka krijohet sot. Osht’ e vërtetë që orientimin stilistik ai mund ta, mund ta formëson individualisht, por ajo duhët t’jetë korrespondente me ate çka domethënë krijohet sot në botë. Nuk mund, krijusi pa informacione të... ta bën jetën e mirfilltë krijuse. Domethënë, unë mendoj që nuk ka qenë ndoni hendikep tepër i madh edhe kthimi këtu, a po.

Petrit Çeku: Jo, po m’intereson domethënë ju përmendët shoqatën e kompozitorve që u kriju mbasi u pavaru n’vitet ‘71, domethënë në ‘71-shin veç u bo Kushtetuta. A mundemi me spjegu edhe në, në jetën e përditshme çfarë efekti ka pasë... ato lëvizje pozitive në Kosovë?

Rafet Rudi: Shiqoni, tash domethënë në vitin ‘70, në fund t’vitet ‘73, ‘74, praktikisht unë jom kthy në, në Prishtinë. Jom, një vit, dy vite kom punu n’shköllë t’muzikës dhe pastaj kam dal në akademi të muzikës dhe në fund, deri n’fund të domethënë punës time aktive kom qenë arsimtar në, në akademi. Në vitet ‘74, domethënë, Kosova ka qenë në mënyrë drastike, ambienti kulturor tjetër nga ai, do t’thotë nëse shiqohët ambienti kulturor po edhe në fushën e muzikës, ndryshim kolosal ka qenë nga ajo kohë të cilën unë e kom lanë me shkuarjen n’studime. Po ajo korrespondon apo domethënë ky ndryshim ka qenë i inicum nga ndryshimet e mdhaja që u zhvillun n’atë kohë në fushën politike, politike shoqnore a po. Domethënë osht’ në ‘66-shën kjo Plenumi i Brioneve, n’68-shën ndryshime të amandamenteve, ‘74-shën ka qenë edhe Kushtetuta e Kosovës dhe përgjithësisht ka qenë një ambient jashtzakonisht dinamik n’fushën e kulturës. Osht’ e vërtetë që ai nivel nuk ka qenë i lartë, domethënë nuk ka qenë shumë i lartë, por kanë qenë ambiciet shumë të mdhaja të këtij mes i ta ndryshojnë gjendjen edhe në fushën e kulturës.

Në këtë kohë siç dihet a po, jonë, jonë kriju institucionet e randsishme në fushën e arsimit t’kulturës. Univerziteti osht’ bo në ‘70-shën a po, pastaj biblioteka osht’ bo e kshtu me radhë, a po. Domethënë, institucionet... osht’ formu orkestra simfonike, osht’ formu, osht’ stabilizu orkestra simfonike, se forma të orkestrës simfonike ka pasë edhe ma parë, por viteve ‘70-ta me formimin e Radio Televizionit

të Prishtinës, si një qendër e madhe domethënë çfarë ka qenë ku tërë jeta muzikore ka qenë e lidhur me Radio Televizionin, osht' formu n'atë kohë a po, në '74, '75... dhe përgjithsisht ajo, ajo kohë ka qenë një, të them ni renesancë a po. Kanë fillu revistat e ndryshme, domethënë kulturore të shfaqen. Ta zamë është "Fjala", ku ka pasë artikuj të ndryshëm domethënë në fushën e muzikës, a po. Une kom qenë n'atë kohë në '75-shin kam fillu edhe të shkruj, '75-shën, '76-shën jonë shkrimet e mija, domethënë datojnë nga ajo kohë, dhe e di ma përafër se çfarë ka qenë ambienti kulturor pikërisht në këto vende.

Domethënë, osht' e vërtetë që ndoshta pak stihike kanë qenë ato, ndërtimi i institucioneve, por osht' shumë randsishme që jonë formu. Në '73-shën osht' formu Akademia e Arteve, dega e artit figurativ. Në '75-shën osht' formu akad... dega e muzikës, pa ndonji kuadër të stabilizum të arsimtarëve, por ka qenë shumë e randsishme se e ka pasë një, një ambicie a po, për një zhillim. Çështje tjera mandej, ajo rrjedha ma vonë ka qenë siç e dimë jo aq e, jo aq domethënë fatlume për këto instutucione, siç dihet a po. Se menjherë në '81-shin jonë bo ato demonstratat e famshme dhe degradimi i jetës kulturore, po ajo osht' diçka të them tjetër.

Përgjithsisht, domethënë në këtë kohë osht', kjo osht' e randsishme në fushën e muzikës që në '74-shën ka fillu edhe festivali "Skena Muzikore e Pishtinës", kshtu është qujt. Festival që, festival që u zhvillu diku në, në nëndor me, është lidhë me ditën e Prishtinës e kshtu me radhë. Ajo nuk është shumë e randsishme, osht' e randsishme se në, përmes këtij festivali kanë depërtu këtu kanë ardhë ansamble të ndryshme, formacione kamertale por edhe orkestrale dhe korale të mdhaja, artistë nga qendra tjera mjaft të zhvillume, nga Lubljana, Zagrebi, Beogradi. Vazhdimisht çdo vit ka pasë ansamble të ndryshme shumë kualitative, shumë kualitative, dhe që kanë zhvillu aktivi... që kanë pasë në program edhe muzikë moderne a po, që ka qenë e randsishme për atë kohë. Përgjithsisht, domethënë ndryshimet kanë qenë radikale, ndonëse, kurrsesi aq të mdhaja që t'i afrohet qendrave tjera të mdhaja në ish Jugosllavinë, po sidoqoftë.

Osht' interesant në këtë kohë të përmendet se meqë ne kemi jetu në, në ni bashksi aq të gjërë çfarë ka qenë Jugosllavia dhe institucionet Radio Televizioni, orkestra simfonike domethënë edhe t'gjitha këto instutucione tjera kulturore kanë, kanë përcjellë një organizim të jetës kulturore muzikore, çfarë ka ekzistiu në qendrat tjera, a po. Kjo ndoshta mund të shiqohet negativisht nga d... nga dikush, por unë e shof atë, atë anën pozitive të saj, për shkak se domethënë në, në një vend ku nuk ka pasë traditë në qeverisje, në organizimin e e jetës kulturore, e institucioneve kulturore, ne e kemi përcjell një, domethënë imitu një organizim a po, përvojë që ka ekzistiu në qendrat tjera. Ta zamë, redaksitë e ndryshme, ka ekzistiu produkcioni muzikor për shkak se ka ekzistiu edhe në Lubljanë, Zagreb edhe në Beograd. Ai është dashtë edhe këtu të formohet ndonëse kuadro s'ka pasë.

Mandej, fizionomia programore e radios, televizionit ka qenë kopje e qendrave të mdhaja. Domethënë, përkundër që nuk ke pasë kuadro, ka qenë modeli i mirë. Këte po e them me qëllim se ma vonë domethënë viteve '90-ta, '90-ta dhe mas luftës tonë a po, nuk ka pasë gjithmonë organizim t'mirë. Nuk osht' përcjellë një traditë e mirë, domethënë nuk osht', nuk jonë marrë gjithmonë modelet e mira për këto organizime të jetës kulturore, a po. Përkundrazi n'ato vitet e '70-ta ka qenë një organizim mjaft i mirë dhe ato na kanë dhonë shansën që njerzit e kulturës të zhvillohën a po. Ta zamë, unë dhetë vite kam qenë anëtarë i redaksisë t'atij festivali, për t'cilin fola, të muzikës moderne në Opati. Sigurisht. jo prej, për shkak meritave, se unë kom qenë fare i ri n'atë kohë a po, kurse atë festival e kanë organizu t'them gjigantët apo të organizimit kulturor muzikor që edhe njifen.

Ta zamë, sallat, orkestrat e njoftun që kanë, njikohsisht kanë udhëheqë, kanë organizu jetën kulturore, sallat dhe orkestrat në Zagreb dhe Lubljanë, dhe ata kanë qenë pjesë e festivalit atje, dhe natyrisht unë me atë, përmes t'them atëherë kemi thënë çelsit që ka qenë, se në organizim është dashtë t'jetë t'gjitha Republikat dhe Krahinat, dhe ne kemi qenë p... ne kemi pasë formalisht vendin e sigurum atje. Kjo ka qenë shumë e ransishme a po dhe për ate dhe ne kemi arritë të shkojmë atje, jo gjithmonë me nivelin tonë artistik, por për shkak se i kemi taku atij ambienti të, të gjërë. Për shembull, edhe ato takimet e Radio Televizionit, dhe orkestrat. Ta zamë unë kom qenë në vitin '80-të apo unë kom... pasë ardhjes nga Parisi a po, unë kom fillu të udhëheq korin profesional të Radio Prishtinës. Profesional, kanë qenë 30-40 vetë të punsum a po, domethënë...

Petrit Çeku: Kur u formu, atë vit?

Rafet Rudi: '80, po n'vitin '80 është formu, dhe unë kom fillu të punoj, dhe pastaj nja shtatë sezona e kom udhëheq dhe praktikisht kom pasë koncerte në t'gjitha vendet e ish Jugosllavisë. Në t'gjitha festivalet e randsishme, në Festivalin e Ohrit, në Beograd, domethënë në festivalin e Dubrovnikut, n'festivalin e Opatisë t'muzikës moderne, dhe ato jonë, ato kanë qenë rutinë, prezentimi i ansambleve tona atje, që ka qenë shumë e favorshme për ne meqë artistikisht, profesionalisht nuk ka qenë nivel bash që të marrin pjesë gjith... nuk ka qenë gjithmonë ai nivel i duhur. Por meqë kemi qenë njësi n'atë ambient apo njësi politike, a po, ne i kemi qfrytzu kto.

Erëmirë Krasniqi: Këtu në Kosovë, me kon komunikojshnit n'këtë nivel profesional?

Rafet Rudi: Shiqoni, domethënë këtu në, sa i përket jetës tonë muzikore, domethënë apo zhvillimit historik të muzikës te ne a po, gjithashtu këto vitet '70-ta kanë një ndryshim esencial. Derisa në vitet '50-ta dhe '60-ta s'ka pasë shumë njerz tanë që kanë studju, por megjithate kanë studju nëpër akademitë e Beogradit, të Sarajevës, të Zagrebit a po, por kanë studju drejtimin e pedagogjisë. Domethënë ju mund t'i dini, ta zamë profesor si Engjëll Berisha, Mark Kaqinari, Vincent Gjini, Akil Koci e kshtu me radhë. Ata të gjithë kanë të mbarum drejtimin e pedagogjisë t'përgjithshme muzikore, a po. Kurse, në fund të viteve '60-ta kanë fillu të dalin kompozitorët e parë profesional. Nuk po flas për cilësi, kualitet, por që kanë qenë të, zejën e vet e kanë mësu a po, në akademi.

Kshtu, domethënë n'atë kohë është kthy Esat Rizvanolli, Fahri Beqiri, osht' kthy prej Lubljanës osht' kthy domethënë Zeqiria Ballata, Rauf Dhomi nga Sarajeva, unë nga Beogradi në '74-tën, domethënë krejt kjo osht' në një periudhë pesë-gjashtë vjeçare, dhe kta jonë, kompozitor jonë instalu në Prishtinë dhe kanë fillu aktivitetin e tyre, a po. Po them, në numër ne edhe më tutje kemi qenë shumë të paktë por sidoqoftë kemi përcjellë një përvojë shumë t'mirë të qendrave në të cilat kemi studju. Ta zamë, Ballata ka përcjellë ni për... ni përvojë shumë të madhe në sh... një frymë, një frymë t're ka sjellë në muzikë, muzikën avangarde. Ta zamë, ne të Beogradit, pak ma shumë a po, mandej edhe Bashkim Shehu ka qenë ai dy-tri vite ma i ri se unë nga Sarajeva, dhe përafërsisht kta kanë qenë njerzit që e kanë, që kanë qenë prezent në jetën muzikore. Ne ende n'atë kohë nuk kemi pasë instrumentist. Kangtarë të zhvillim dhe instrumentist të zhvillim.

Domethënë, njëherë kanë qenë kompozitorët, dirigjent, Bahri Qela ka qenë dirigjenti ynë i parë që ka diplomu dirigjimin e kshtu me radhë. Dhe domethënë ata jonë lidhë. Pastaj kanë qenë prezent në fakulltetin në akademinë e muzikës si, si pjesmarrës në skenën muzikore të Prishtinës. '79-shën osht' formu edhe festivali tjetër "Ditët e Muzikës Kosovare", a po. Aty kemi qenë Ballata dhe une një iniciator. Në Gjakovë osht' majtë. Pse ka qenë e randsishme? Jo për ndonji zhvillim shumë të madh,

ndikim shumë të madh në, në publik e kshtu me radhë, por ka qenë e randsishme për shkak se jonë ekzekutu veprat shumë moderne t'krijimtarisë tonë, a po. Kanë pasë, kanë pa dritë a po. Bile unë mund t'them se kompozitorët shumë të parë në numër, ta zamë unë siç kam qenë i ri apo Bashkimi, apo ma vonë Gjon Gjevelekaj e kshtu me radhë, kemi qenë, unë tash e shof bile t'privilegjum se neve kanë mundur të na ekzekutojnë veprat ansamblet, orkestrat e mira të ish Jugosllavisë, që kompozitorët sot tanë të ri osht' e paparamendushme. S'osht' e mundur ni orkestër e Zagrebit me ja ekzekutu kompozitorit tonë të ri, a po, ose Lubljana. Ajo ka qenë e pa... sot osht' e pa, osht' e paparamendushme, a po, dhe ne i kemi pasë këto.

N'atë kohë noshta osht' dhe e randsishme se unë kom shetit mjaft nëpër këto qendra të ndryshme. Jom furnizu me partitura t'muzikës moderne e kshtu me radhë, dhe kom pasë ambicie të dal edhe të studjoj, dhe në vitin '79 unë kom shku edhe në Paris, si bursist i qeverisë franceze. Edhe aty ne e kemi shfrytëzu ni kuotë që e kemi pasë domethënë, dome... të atij ambienti që e kemi, që ka qenë, që osht' qujt Jugosllavi, a po. Se ne kemi shku përmes Ministrisë të Punëve të Jashtme të, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës, a po. Jonë, kanë qenë t'sigurume do bursa për artistët, artistët domethënë Jugosllav, dhe ndonjiherë edhe ne kemi marrë kshtu a po. Kshtu, kanë qenë, ta zamë Sabri Hamiti, Ibrahim Rugova a po, ni vit para meje, dhe une i treti jom në këtë radhën e ktyre domethënë përfitusve të ksaj burse mjaft të randsishme.

Unë kom qëndru ni vit në Paris, i kom pasë t'gjitha benefitet e mundshme, e kom pasë bursën, t'sigurum qëndrimin, kom... domethënë e kom pasë t'sigurum mësimin te ni kompozitor kom studju, mjaft i randsishëm i muzikës Franceze, te Claude Ballif dhe mund ta quaj se Parisi ka qenë ni prej pikave ndoshta të dytë... pika e dytë e randsishme në formimin tim si muziktar. Tash, t'ju them për Paris se çfarë ka pasë atje, ndoshta osht' e tepërt a po. Domethënë ajo ka qenë, s'pari ka qenë ni, përkundër ktyre detaleve që i spjegova lidhur me zhvillimin e jetës kulturore në ish Jugosllavi, në Beograd e kshtu, megjithate domethënë kontakti me Paris ajo ka qenë shokante për mu, absolutisht a po, absolutisht. Domethënë ajo osht' determinuse absolutisht në zhvillimin tim, domethënë në zhvillimin si edhe kompozitor por edhe si, edhe zhvillimin tim si intelektual.

Kalimthi t'them, ky kompozitori, profesori im në Paris, ai ka qenë edhe ni teoricient, domethënë {tregon me dorë kah biblioteka lartë prapa tij} shumë libra t'tij unë i kam, filozof ka qenë dhe ka qenë ni kompozitor atonalist, i shkollës së Darmstadit, të njoftun a po? Domethënë, domethënë ata post-vebernistët e kanë zhvillu ate, domethënë Boulezi, domethënë e Hans [Zimmer] e disa kompozitor, Stockhausen e kshtu me radhë. Domethënë, kanë qenë domethënë në ni lulzim të plotë t'viteve '50-ta, dhe ky i takon asaj rryme, dhe une te ky kom msu kompozim. Gjithmonë nuk kom qenë dakord me orientimin e tij, se ka qenë mjaft ekstrem për, tash e shof a po, për bindjen time, por kom fitu gjithashtu në ni fushë tjetër që unë e kom zhvillu pastaj, fusha e estetikës, e filozofisë, e teorisë t'muzikës kshtu përgjithsisht. Përmes tij unë kom fillu të mendoj për muzikën ma tepër. Ai ka qenë një po them, po e përsëris, një filozof që i ka interesu jashtzakonisht, mu më ka interesu unë kom nxitë biseda, por pastaj edhe ai ka pa disa gjëra te unë domethënë të lidhjes së literaturës, filozofis dhe artit muzikor që ne i kemi diskutu shumë përmes tij.

Përgjithësisht, domethënë Parisi, Parisi domethënë ai vit për mu m'ka bo që pastaj unë të lidhem me kulturën franceze dhe këtë bibliotekë {tregon me të dy duart kah biblioteka} që ju e shifni, domethënë një pjesë të madhe e kam pikërisht në gjuhën frenge, për shkak se mandej kom vazhdu une t'jem i lidhur edhe me gjuhën, literaturën frenge, domethënë edhe me, me kulturën me... domethënë, përgjithësisht me ni botë kulturore frenge. Ta zamë ndoshta nuk është krejtsisht e parandsishme që

unë lexoj ta z... vetëm frengjisht praktikisht, a po, literaturën dhe beletistikën edhe këte. Kurse ngritjen e profesionale a po, ajo osht' shumë domethanse për shkak se librat teorik, ta zamë librat këtu {tregon me dorë kah biblioteka} teorik që i kom, ato nuk jonë n'shqip kurrsesi, po as, as serbisht e kroatisht nuk jonë a po. Domethënë ato gjinden në gjuhë në anglisht siç e dimë, apo gjermanisht, frengjisht dhe ajo më ka, domethënë më ka mundsu pikrisht ajo njohje e kulturës që pastaj une e kom kultivu.

Unë çdo vit kom shku në Francë. Natyrisht, jo viteve të '90-ta qysh mundeni me, mund ta merrni me mend. N'atë terrin kulturor a po, që ka qenë në Kosovë, a po, që s'kemi mundur të shkojmë a po, për dallim nga një periudhë e maparshme që unë ju tregova që kom shku nëpër festivale dhe ne nuk kemi pasë nevojë për viza ne... na nuk kemi ditë çka osht' viza n'atë kohë, për domethënë viteve '60-ta, '70-ta. Domethënë, po, po flas për këtë kohë e pas luftës tonë, a po, që unë kom va... domethënë kjo tash po, po bohët 18 vjet a po, që unë kom vazhdu domethënë të shkoj vazhdimisht në Paris, në Paris e në Strasburg e kshtu me radhë, dh... dhe t'jem i lidhur me kulturën domethënë franceze.

Pjesa e Katërt

Petrit Çeku: A ka qenë Ehat Musa n'atë kohë kitarist?

Rafet Rudi: Po. Praktikisht bashkëpunimi, lidhja me Ehatin daton edhe ma parë. Ne kur, unë kur kom studju në Beograd edhe Ehati ka qenë, Ehat Musa ka qenë student i Beogradit.

Petrit Çeku: A po?

Rafet Rudi: Po, po. Para se t'shkon në, në domethënë në Paris. Në '70-shën, në '71-shën ne jemi shoqëru dhe pastaj ai ka shku në '71-shin, ka shku në Paris. Kshtu që, unë e kom shfrytëzu atë lidhjen tonë që kemi pasë, shoqërimin tonë që disi të depërtoj t'them në atë Parisin e madh, a po. Domethënë, të depërtoj n'kuptimin, ta kuptoj ma mirë a po. Bile, kalimthi them para se t'shkoj në studime a po, unë disa muj, një vjet përpara kom qëndru nja ni muj në shtëpinë e, e Ehatit, kshtu vetëm të ambientohem domethënë pa bursë a po, privatisht. Edhe ky është detal shumë i randsishëm, domethënë ne atë kohë me rrogat tona kemi mundur të udhtojmë edhe në Paris a po. Domethënë kjo osht' ni detal domethënës a po, domethënë që sot kush munet me ni rrogë të shkon të qëndron ni muj ditë në Paris a po.

Osht' e pamundur, a po? Dhe domethënë përmes Ehatit unë disi e kom njoftu ma mirë dhe apo ma afër Parisin se ai kishte një periudhë t'gjatë që qëndronte aty, dhe përmes kontaktit me te, bashkëpunimit që për atë kohë sa edhe kom qenë ma afër atje në Paris ka lind edhe ideja që disi të, të merrem ma shumë me muzikën për kitarë. Ajo ka qenë domethënë vitet '78, '79, '80, '81, '82, domethënë kur unë kom shkrujt një mori veprash për kitarë domethënë, "Rrojtjën", "Suitën", "Sonatën", mandej ma vonë vjen "Koncerti" e kshtu me radhë. Domethënë dhe, ndoshta është e randsishme që Ehati, meqë ka pasë atë, të them një, një përvojë ma t'madhe me ambientin kulturor, unë domethënë përmes edhe tij, përme... përmes tij, atij rrethi që ai ka pasë unë jom fut të them n'atë ambient pak ma tepër.

Kom njoft ta zamë Rafael Andin a po, profesorin e njoftun dhe editorin a po. Domethënë, falë edhe

kësaj njohje pastaj edhe osht' botu botimi i parë i "Suitës" në Paris prej shtëpisë botuse "Transatlantic" që ka mundsu pastaj edhe t'them ni njohje relative a po, e imja në përmasa pak ma të gjëra. Ato natyrisht kanë qenë t'rëndsishtme nga ky ambient që ka qenë relativisht i vdekur, a po, i Prishtinës. Ajo ka mundësu që ndoshta veprën ta shohësh të interpretume atje apo ma, ma shumë. Qe kshtu sa i përket Parisit. Kshtu, këte që thash se ajo ka qenë shokante, ka qenë për faktin se domethënë kanë qenë koncerte të nivelit jashtzakonisht a po, qysh edhe nënkuptohët. Unë osht' e vërtetë që kom pa orkestra t'rëndsishtme, emra t'ransishme në Beograd, por kur kom shku në Beograd... në Paris unë e kom pa se ata kanë ardhë kalimthi në Beograd. Ata atje kanë jetu (qesh). Mandej, kjo ka qenë natyrisht edhe përvojë që tërë zhvillimin tond ta shef nga një perspektivë tjetër a po, kur shkon n'atë vend.

Osht' interesant ndoshta dhe ky detal me profesorin tim që shpeshherë e kom spjegu edhe studentëve. Unë kur kom qenë atje me profesorin, ne kemi ndëgju muzikë shqipe. Po, shumë interesant. Muzikën e jugut unë ia kom lshu që ta dëgjojë profesori Claude Ballif, dhe ai m'ka thënë se i duket si tingllima, kjo osht' domethënëse për muzikën tonë shqiptare, tingllima si Leotenus dhe Perutinus. Leotem, Peroten jonë dy kompozitor që e zhvillojnë traditën e No... shkollës së Notredamit të shekullit dymdhetë, tremdhetë a po, a, po. Dhe, ai kshtu e ka ndëgju, e ka ndëgju, dhe për mu ka qenë, për shembull, ky detal enigmatik. Natyrisht, unë kam bo konstruktive të shumta se ajo osht' muzikë e vjetër dhe edhe kjo ka qenë një dëshmi, një tingllim e një muz... një polifoni e padëgjume, por si duket e rujtur edhe korresponduse me ni pjesë të Europës. Unë kshtu e kom kuptu, por jo në detale, në detale. Osht' interesant, para disa vite unë e kom shkrujt ni vepër "Ulu mal, të del hëna". Ja kom kushtu profesorit Claude Ballif. Nuk osht' kjo e randsishme, ai moti ka vdekë e kshtu me radhë, por aty kom marrë muzikë të Perotinus, Peroten, Peroten kompozitor i shekullit tremdhjet, dhe muzikë t'jugut dhe i kom bashku.

Natyrisht, une menjherë them se unë edhe gjatë veprës time krijuse, e kom pasë këtë ide parasysh, por nuk kam mundur t'i kuptoj qysh mund të lidhet domethënë shkolla e vjetër polifonike e Notredamit me muzikën shqiptare të jugut. Dhe në ni moment, domethënë kom pasë ni ide të lidhjes dhe osht' ni vepër, natyrisht ni vepër modeste për kor a po, osht' ekzekutu e kemi ekzekutu domethënë nuk gjendet në youtube kshtu nuk e kemi plasu, por është e randsishme se paralel kom fillu në pikpamjet tingullore ta ngërthej një muzikë në tjetrën. Në një, do të thotë, në një ambicie apo në një ide se në këtë mënyrë duhet ta ketë ndëgju Claude Ballif muzikën shqipe n'atë kohë. Ka qenë i impresionum përndryshe a po. Ka qenë shumë i impresionum me atë pasuri të folklorit a po. Domethënë, t'gjitha ato inçizimet që me javë, që i kemi dëgju për mu ka qenë gjithashtu domethënë ni mësim shumë i madh në kuptimin se nga atje une kom pa disa vlera që ekzistojnë, po domethënë thjeshtë muzika jonë popullore, më konkretisht muzika e jugut, që duhet t'ketë ni lashtësi të madhe, që njeriu kur osht' ktu nuk i shef gjithmonë.

Erëmirë Krasniqi: E qysh e krijuat ju kontaktin me muzikën e jugut në të '80-tat?

Rafet Rudi: Ah, po. Edhe kjo ka interes, ka ni, ni storie interesant. Domethënë, unë atje në Paris kom kontaktu edhe disa studentë të Shqiprisë. Para se të gjithash, ato vite komunikimi Kosovë-Shqipri ka qenë, në '77-shën, në '78-shën, '79-shën, '80-shën. Unë kom qenë d... nja dy vite, para se t'shkoj në Paris, në Shqipëri dhe sipas gjitha gjasave kom, aty kom marrë diçka inçizime. Por, lidhja tjetër ka qenë edhe përmes disa kolegëve shqiptarë, që s'kanë qenë t'muzikës. Bile ka, jonë do ftyra publike, ministra e kshtu njerëz shumë të afërt edhe të partisë të Ramës, që njeni posaqërisht, apo Etem Rukun, unë e kom pasë ni shok edhe ai ma vonë osht', osht', ka zhvillu karrierë t'madhe edhe

univerzitare edhe politike e kshtu me radhë. Kjo nuk osht' e randsishme, por përmes tij dhe përmes ktyre studentëve unë kom mrrri te këto inçizimet.

Nuk osht' ajo ma e randsishmja. Ma e randsishmja osht' që une osht' dashtë t'i zhduki ato kasetat kur jom kthy në Prishtinë. Po, kjo osht' e dhimshme. Unë, n'atë pjesën atje {kthehet tregon kah e majta e tij} kom kasetat e asaj kohe të muzikës moderne që unë kom ndëgju, inçizu nëpër radio. Në Radio France, *France Musique* dhe *France Culture* a, jonë dy stacione që edhe sot, edhe sot i ndëgjoj. Tash i ndëgjoj me internet shumë ma mirë se n'ato kushte që ka qenë (qesh) në Paris, por kjo është diçka tjetër, a po, dhe domethënë dhe kur jom kthy prej Parisit, unë osht' dashtë një kofer të tërë ta kem me këto kasetat.

Erëmirë Krasniqi: Pse e shkatrrutë, a mundemi me na i tregu arsytet?

Rafet Rudi: Eh, po. Domethënë, unë i kom kthy t'gjitha kasetat, përpos kasetat e muzikës shqipe, për shkak, domethënë edhe ni detal që ndoshta kalon caqet e këtij të them, këtij prezentimi kompozitorial timin. Unë viteve të '70-ta kom qenë i afërt me Jusuf Gërvallën. Domethënë ne kemi sh... qenë shumë t'afërt, jashtzakonisht, viteve... katër, pesë vitet e fundit sigurisht njeriu më i afërt ka qenë, unë kom qenë më i afërt i tij, unë kom qenë, a po. Edhe kemi shkrujt, edhe këto festivalet që ju përmenda n'skenën muzikore e kshtu me radhë, ne kemi nënshkru ni mori, ni mori artikujsht a po, që i kemi udhëheq. Dhe ai n'atë kohë domethënë në ndjekje nga policia serbe, ai domethënë ka, e ka braktisë Kosovën osht' instalu në Gjermani, siç dihet domethënë. Dhe unë kom qenë në shënjestër a po.

Natyrisht, unë tërë kohën kom prit që edhe une do t'gjej fatin e ktyre njerëzve tjerë që domethënë kanë përjetu, të kulturës tonë, ndonji burgosje ose kësi lloji. Bile, unë kom pasë sinjale konkrete për këte, por nuk ka ndodhë ajo. Nuk ka ndodhë për shkak se unë lidhjet me Jusufin kanë qenë ma tepë... jo ma tepër, por kanë qenë në një rrafsh tjetër, jo të veprimtarisë ilegale... jo, jo unë, bile edhe kur e kom komentu me Jusufin këto lëvizjet ilegale m'çuditë se si ai ka pasë mirëkuptim për qëndrimin tim, se unë kom qenë kundër. Kundër në kuptimin që unë kom thon ni njeri, ni intelektual i vlefshëm i yni duhet të kryen shkolla dhe duhet n'forma të tjera ta çojë luftën kombtare, e jo me ni traktat ose ni afishe, dhe ai osht' dakordu me mu.

Kurse prej Suzanës kom marrë vesh, shoqës së Jusufit, se n'ato bisedat t'pafundme që kom, që kemi zhvillu për kulturën, artin e literaturën me Jusufin, ai ka qenë njohës i mrekullushëm i literaturës moderne a. Domethënë, unë kom ndikim shumë të madh pikërisht nga ai, ai, n'ato biseda kanë prit që të kryhet ajo bisedë e pafundme me Jusufin dhe kanë dal mandej kanë nda, i ka shpërnda traktatet (qesh), që mu, mu ka dukë... a unë si kom ditë këto. Natyrisht, unë kom mund të mendoj që ai do bëjë ndonji vepër t'madhe, po unë s'kom qenë bashkëpuntor n'ato, për shkak se une absolutisht kom mendu ndryshe që duhet... dhe sot m'dhimët që, edhe sot mendoj që duhet ndryshe. Domethënë, lufta patriotike duhet t'jetë në pajtim me fizionominë, me karakterin e profesionit që ka. Shkrimtari duhet ta bon punën e vet ma mirë, kompozitori duhet ta bon punën e vet ma cilësore dhe ashtu i kontribon, a po.

Mirë, ta përfu... të kthehemi te ajo që thashë më parë. Unë kom qenë në shënjestër. Kom marrë sinjale konkrete, konkrete nga burime të, shumë të, domethënë shumë kompetente a po, që kom qenë, pikërisht n'atë kohë Jusufi ka shku dhe kom qenë në shënjestër dhe unë s'kom guxu fare të kem këto materiale, a po, dhe ato sot m'duken an... anomali, paradoks. Po, ajo ka qenë fatale ka mund t'jetë, a

po, një inçizim i tillë ka mund t'jetë fatale dhe për ate une krejt ato kasete i kom zhduk, a po, krejt ato kasete. Më kish interesu bile cilat, cilën muzikë ia kom prezentu profesorit, a po, në Paris. Unë nuk e di konkretisht, a po. Se unë e kom ditë muzikën kshtu, po nuk e di cilën këngë tamam, a po, cilën këngë, cilën... dhe që kshtu osht' ajo domethënë kjo periudhë e të them, e Parisit.

Domethënë, nuk është çështja Parisi apo ai kontakt tepër pse unë kom ndëgju vetëm orkestra t'mira, apo vetëm artistë t'mirë, vetëm ngjarje të mdhaja, por, nga ajo pozitë njeriu e vështron shumë ma mirë rrjedhën këtu. Unë kom fillu domethënë ta kuptoj ma, ma qartë, ta shof vlerat e muzikës shqipe, shqiptare, ato vlera që i ke, ato vlerë që i ke, a po. Domethënë, kur je pak ma larg domethënë ajo distancë t'them edhe fizike a po, por sidomos kulturore e ambientit a po, e shef ma mirë ambientin të cilën ti do t'i kthehesh a po. Osht' ambient i yti inicial, a po, dhe unë e kom pa shumë ma mirë dhe nuk osht' e paransishme ajo se zhvillimi apo përcjellja e të them standardeve që ekzistojnë në një qendër kulturore. S'pari njëherë hetimi, kuptimi, përjetimi i atyre standardeve, ajo osht', ajo t'bon mirë që pastaj ti në një ambient të pazhvillum qysh kemi qenë, t'i plasosh dhe t'mundohesh t'i ruash ato standarde. Ato nuk, ato standarde nuk i shef në qoftëse shkon njëherë në Paris, për shembull a po, e shef ni koncert edhe kthehesh, edhe kshtu duhët me bo. Jo, kur e... atëherë kur e përjeton ritmin e një qendre t'madhe.

Tash, për shembull kalimthi në sallën Imperial a po, domethënë '83-shën kur kom pasë... po në '83-shën unë kom pasë koncert me korin, n'sallën Imperial të festivalit që ju spjegova t'muzikës moderne. Unë i kom marrë tre kavallist popullor. Popullor kanë qenë, që s'ka ditë me muzikë ai, i ka ra folkl... domethënë i ka ra motiveve popullore me kavall, a po, dhe ka qenë i, ni vepër "Flijimi" që osht' vepër mjaft domethënëse për mu, jo për dikend tjetër a po kupton. E une e kom përdor. Unë tanë kohën me folklor mirrem. Po, tanë kohën merrem me folklor nga pozita e kompozitorit. Për shembull tash, qe këtu {tregon me dorë në të majt} qe duhët tash t'ekzekutohet, veprën qe jom duhet javën tjetër t'hyn punt me... osht' prapë me folklor. Por, e osht' par... jo parodi, osht' thirrje në atë veprën "In C" e Terry Riley. Terry Riley, Terry Riley, Terry Riley e ka veprën "Kunte" të muzikës post moderne. "In C" quhet. E une, kjo vepër quhet "In A", a po kupton, edhe bile duhet shumë me ju spjegu korit se asnjoni s'dinë çka osht' "In C", "In A", domethënë. Kurse aty ka popullore, domethënë a po, domethënë...

Erëmirë Krasniqi: N'atë kuptim edhe une mendova...

Rafet Rudi: Po, po. Kurse, une i admiroj ata që shumë shpejt, jonë fleksibil, a po m'kupton. Une, jo, une kom qef s'po flas për përvojë jo tash, po për përvojë s... s'kom qef m'u përzi. Për shembull, unë, unë kom... mjaft mirë dikur i kom ra pianos, po unë s'kom pasë qef me dal si pianist, a din. Ose për shembull, m'falni që pe boj kët' digresion kshtu, po për shembull s'po di, Ballata ia lejon vetit me dal si pian... pianist. Nuk kom kundër, ai le t'bon. Unë për veti... shiqo, me dal, ai del, në Opati ka dalë. Me shku une në Opati m'i ra, ai Pavica Gvozdic aty, edhe une m'i ra. Ani Vladimir Krpan edhe une mu ulë te piano, po. Kom respekt ndaj profesionit, nivelit, a po. Domethënë edhe për ate nuk e kom leju ashtu, a din, me dal n'profesion tjetër, a po kupton. Meqenëse, tash kur po e kqyri po e shof që me shumë profesione jom marrë, edhe me shkrime, edhe me... Po këto shkrimet jonë të logjikshme se këto shkrimet jonë t'kuptushme nga pozita e kompozitorit, jo nga pozita e një muzikologu. Se kom shkrime shumë, shumë shkrime, domethënë katërqind-pesqind shkrime jonë, a po kupton, kurse, ato kritika apo shkrime t'vogla kshtu.... Mirë...

Petrit Çeku: Kshtu, po, hmm... po, ndoshta m'u.... Veç ni detaj kshtu prej s'fillimi, prej kontaktit t'parë

me muzikën. Te “Suita” për kitarë e kom pa një mënyrë shumë t’rafinume të inkludimit të folklorit ose të disa motiveve sidomos nga jugu. Po supozoj që kjo osht’ e lidhun edhe me atë inçizimin që keni pasë në Paris t’cilat i keni shkatrru ma vonë. Po m’intereson kronologjikisht kur ka fillu inkuadrimi i njifarë tendence nationale t’muzikës popullore?

Rafet Rudi: Aha. Kshtu, po. Po, po. Shiqo, domethënë prej veprës t’parë, interesant osht’ domethënë se profesori im në Beograd ka insistu që t... të merren temat popullore të futen në vepra, dhe praktikisht veprat e mija t’para Suita, Sonata, Variacioni, Kuarteti Harkor, e kshtu me radhë, të vitit t’studimit, t’gjitha kanë nga një këngë popullore. Shumë osht’ interesant. Domethënë ai, ka qenë gati mund t’them e nënkuptushme. Po ai ka qenë edhe mekanike n’kuptimin se domethënë ka insistu profesori, kshtu thjesht. Nuk osht’ ndonji bindje e ime. Kurse, ma vonë domethënë ma vonë, domethënë ka qenë një, një bindje n’kuptimin, bindje krijuse. Ka qenë një, një kshtu një ambicie e ime e brendshme që të bëhet ni, ni lidhje e, e domethënë e muzikës sa ma avangarde me, domethënë me muzikën shqipe. Dhe kjo, domethënë, jo gjithmonë në formë të citatit a po, po gjithmonë ty tentu që ta bësh atë harmonizim sa ma logjik. Dhe tash, kjo osht’ ai, ai, ai idiomi krijus a po.

Ky osht’ ni ambicie shumë e thellë e ime që gjithmonë nuk kom pasë sukses. Por, ambicie gjithmonë kam pasë n’atë drejtim. Domethënë që, pamvarsisht se a, çfarë orientimi sto... stilistik zgjedh kompozitori, e shkrun apo është, muzika shqipe mund t’jetë një shans. Jo n’kuptimin e propagandës, a po domethënë ndonji pamflet patriotik. Jo, për diçka, ndonji qëllim kshtu paraprakisht të mendum por n’kuptimin se ai është ni shans e mirë domethënë që, domethënë të, të, ni burim i mirë për, për krijimin e veprës, a po. Pamvarësisht se vepra a shkruhet në mënyrë, mënyrë neoklasike tonale apo do t’shkruhet në mënyrë atonale, a po. Domethënë osht’ e mundshme. Në “Suitë” edhe në “Rrojtje” ke, edhe në secilin ka diçka, domethënë popullore a po, popullore. Por, gjithmonë jom mundu që ajo t’jetë diku n’nivel ma t’lartë, po gjithmonë nuk kom arritë, a po, dhe n’veprat e fundit ajo lidhje ekziston.

Mjerisht te ne nuk ka shumë, shumë kshtu domethënë punime n... etnomuzikologjike t’besushme, a po. T’besushme që ti ta dish se cila osht’ muzika shqipe, a po, dhe ta marrësh ate, a po. Domethënë, dhe ne e kemi fatin që ndonjiherë muzikën thjesht orientale ne e kemi. Motivet orientale, po flas për krijimtarinë e kompozitorve kosovarë përgjithsisht, edhe veten e shof aty, që osht’ marrë ndoni motiv or... thjesht oriental në kuptimin se, në bindjen tonë se e kemi marrë muzikën shqipe. Ai, po, domethënë ti nuk e ke gjithmonë ate, a. Zatën edhe osht’ shumë vështirë ta gjesh muzikën, çka osht’ në muzikën shqipe shqiptare, dhe çka osht’ në ndikimin oriental a po.

Ky osht’ ni problem shumë i madh dhe në këtë drejtim etnomuzikologjia jonë nuk ka punu, nuk ka... Po flas edhe këtu edhe në Shqipëri, nuk ka, nuk ka aq shumë domethënë rezultate. Për ate, ai moment që kur e ka ndëgju profesori im atë muzikën e jugut dhe e ka bo me, ka vendos paralelen mes asaj muzike dhe muzikës domethënë të shekullit XII, XIII, të muzikës franqeze a po, atëherë m’u ka dukë ni mister, a po. Mjaft, mjaft, mjaft kshtu tërhekës, se çka mshefet aty. Mos ekziston mundësia, se ne e dimë edhe ajo muzikë e shkollës së Notredamit a po, domethënë traditës Notredamit t’shekullit XII, XIII, këndimit të Notredamit a po shkollës të Notredamit, edhe ajo osht’ muzikë nationale franqeze. Nuk osht’ ajo muzikë e rafinume e kohës së Renesancës edhe Barokut, osht’ shumë ma rudimentare, kshtu. Domethënë, duhët t’jetë shumë ma popullore ajo muzikë, dhe ajo osht’ e afërt me muzikën tonë t’jugut.

Mos ekziston një lidhje ma e thellë e ksaj muzike, ndoshta edhe të shekujve ma t... ma t’hershëm a po.

Natyrisht që nuk ka kurrfarë hulumtimi në këtë drejtim, a po, dhe për ate domethënë këto, këto domethënë, këto veprat e mija që kanë mbështetjen në folklor në mënyrë permanente në t'gjitha veprat, gjithmonë nuk kanë qenë, nuk janë t'sigurtë që janë lidhë me muzikën shqipe se vet muzika shqipe nuk është shumë e qartë, ajo domethënë konstrukti, struktura melodike, motivore, modit, nuk janë t'qartësime, a po. Na, natyrisht, ne imagjinojmë, ne gjithmonë, por nuk është ashtu, a. Domethënë...

Petrit Çeku: Kthehemi pak te muzika. A keni pasë, a keni qenë të censurum, a ju kujtohet ndonji...

Rafet Rudi: Periudhë? Po...

Petrit Çeku: M'dokët që njëherë patëm diskutu ni çashtje të ni teksti që është konsideru pak...

Rafet Rudi: Aaa. Jo. Unë kom qenë kshtu i censurum në mënyrë, domethënë formale. Në momentin.... Po, kjo është ni moment tjetër. Unë gjithmonë domethënë duhet t'kem qenë në sy të dikujt, a po. Ndonëse, kurrë s'jom marrë me politikë. Fare. Kurrë s'kom qenë aktiv politikisht, a po. Por, që nga koha domethënë e asaj periudhe e, a po, të lidhjes time, domethënë shoqëritim tim me Jusufin, unë dikun kom qenë në ni sy të keq, dhe në punën time si dirigjent, a po, n'korin profesional të radios, domethënë unë kom pasë ni incident. Unë jom, unë jom përjashtu nga kori, domethënë në '87-shën.

Mirë, kjo po e spjegoj krejt tamam kshtu, dhe kom qenë i censurum a po, kjo është e, kjo është ndoshta ajo që... përgjegje kte që e bëre pytjen. Domethënë, ajo ka qenë në '87-shën, ka qenë një ditë e radios tradicionale që është majt. Ka qenë në sallë Kryetari i Republikës Serbisë, Kryetari i Komitetit Qendror Serbisë e Kryetari i Kosovës, e kshtu me radhë. Ato kanë qenë, kori ka qenë gjithmonë prezent n'ato manifestime, apo domethënë protokolare, a po, dhe ka qenë një koncert në radio dhe zakonisht nuk është shkrujt programi. Ka pasë zakonisht disa pika artistike të zakonshme a po, çdo vit kemi pasë disa pika zak... artistike dhe pastaj është dashtë të këndohet ajo n'atë, n'atë euforinë nacionaliste a po, që ka qenë viteve '80-a kënga "Shoku Tito, ne të betohemi", a po. Domethënë n'fund ajo si hymn është dhanë, dhe atë vit për çudi e kanë shkrujt programin dhe ka figurë edhe kjo, hymni, që nuk ka pasë nevojë të shkruhet. Dhe kur ka mbaru programi artistik unë i kom dhonë shej një, domethënë korit që të del nga skena dhe ata kanë prit "Shoku Tito, ne të betohemi". Krejt ky establishmenti ynë politik, edhe une si guximtari ma i madh, natyrisht unë s'kom ditë çka po ndodhë fare a po, domethënë për shkak se ni anëtar i korit e ka këndu papastër a po, krejt kshtu.

Domethënë edhe kom dal pas koncertit, dhe kom pasë sinjale të vogla që kom bo një incident, a po. Mandej njeni, një njeri i yni, e ka, m'ka bo t'vetdijshëm se kjo për herën e tretë unë pas... nuk e paskëm këndu, "Shoku Tito, ne të betohemi". E ka konstatu ai, unë s'kom ditë për këtë (qesh). Domethënë... edhe unë kom shku në shtëpi, dhe mandej ka fillu ni fushatë n'gazetat Beogradase. Në "Politika", në "Novosti" e kshtu, domethënë që i kom pasë une ato. Une nuk kom ditë, se ka qenë vikend, edhe të dielën ka ardhë njeriu zyrtar prej Radio Televizionit dhe ma ka dhanë atë përjashtimin nga puna në korin e Radio Televizionit. Unë s... s'kom ditë. Kur i kom marrë ga... gazetata, i kom pa ato shkrime, ato kanë qenë të tmerrshme. Ato kanë qenë thirrje për linçim, burgosje e kshtu me radhë, a po. Të tmerrshme a po, domethënë që unë fare nuk kom ditë, dhe nga ajo ditë une, veprat e mija kanë qenë të ndërprera në radio, a po.

Erëmirë Krasniqi: A është kjo fillimi i nacionalizmit i Millosheviqit?

Rafet Rudi: Po, se osht' tamam '80... taman ajo osht' faza e fundit para se me ardhë, para që, se Millosheviqi të fiton atje, a po. Ai në '87-shën ka ardhë në krye, a po. Kjo ka ndodhë domethënë në fillim të '87-shës. Mandej 19 vjet unë nuk kom dirigju, a po. Domethënë, kshtu osht' fati (qesh). Por, mirë mandej pas disa muje, a po, natyrisht shqiptarët që kanë qenë në radio, televizione, në gazeta, në mënyrë të heshtun une e kom pasë përkrahjen e tyre. Njerëzve që kanë qenë, qoftë drejtor apo kshtu. Por, nuk kanë mundur haptaz të më ndihmojnë, a po. Domethënë, ajo ka qenë një periudhë jashtzakonisht e rrezikshme, a. Domethënë, që ndoshta gjeneratës tash nuk munden ta kuptojnë se aty domethënë kanë pësu njerzit qysh dihet, a po.

Domethënë, me kësi gjana banale. Nuk kanë pësu pse ka pasë ai program, e ka, ka organizu ushtrinë. Jo, jo, ajo ka qenë një artikull (qesh), ni diçka dhe ka marrë dhetë vjet mandej, dhetë, pesëmdhetë vjet, a po. Kshtu kanë ndodhë. Intelektualët kshtu kanë shku, a. Domethënë, nuk ka pasë diçka serioze, serioze, dhe ajo ka mujt natyrisht shumë letë edhe të ndodhë me mu, dhe natyrisht kish qenë krejt një rrjedhë tjetër, a po. Por, ato vep... veprat në radio kanë qenë të ndalume. Këto kanë, atje n'atë kohë ka qenë e randsishme a jonë të ndalume apo s'jonë të ndalume, për shkak se veprat tona jonë ndëgju shumë në radio. Kurse tash jonë krejtsisht t'ndalume n'mënyrë miqësore, a po (qeshin të gjithë). Domethënë kalimthi, ndoshta s'është kjo për me, për këtë rast, por ne kemi marrë tantjema¹ të mdhaja n'atë kohë. Domethënë, një, një buxhet vjetor, ni pjesë e madhe e buxhetit vjetor osht' marrë për shkak që jonë shku veprat tua nëpër radio, a po, nëpër televizion.

Petrit Çeku: N'gjitha radiot e ish Jugosllavisë ato jonë lëshu?

Rafet Rudi: Po, po, natyrisht. Ato kanë qenë shumë të klasifikume, të sistemune. Në qofse vepra osht' ekzekutu në Radio Televizionin Jugosllav, në terminin tetë deri nandë pas lajmeve, ato kanë pasë pagesa shumë të mdhaja. Domethënë tantjema shumë të mdhaja. Natyrisht tash, tash nuk merremi me kto.

Tash ata që bojn *shund*², a po, kanë bo do organizim për t'drejtat e autorve kshu, a po. Shunt, që bojn, shunt t'pastër a po, ata dojnë t'i mbrojnë të drejtat e tyre, a po? Neve nuk na pysin, a po, se ne nuk jemi prezent fare, edhe këto jonë sporadike. Kurse ne kemi qenë t'mbrojtur jashtzakonisht si kompozitor. Unë kom marrë honorare nga jashtë, edhe nga Moskva, që osht' ekzekutu vepra, a po. Domethënë, nuk kanë qenë të mdhaja nga jashtë, por ato jonë... se ka pasë shkëmbime, ka pasë shkëmbime, po, shkëmbime të Radio Televizionit Jugosllav me Radio Televizionet e përbollshme. Domethënë, dhe ato shkëmbime jonë ekzekutu veprat, a po. Jonë ndëgju veprat e kshtu me radhë, dhe mandej ajo në një jetë jo t'organizume fare, a po, pas çlirimit, domethënë krijimtaria jonë osht' në ni gjendje, n'këtë domen t'vajtushme a po, domethënë. Çashtje tjetër që në domenin, në, në intesifikimin e jetës muzikore a po, osht' shku shumë ma tepër, qysh dihet a po, pas luftës. Por në mediumet e radios, televizioni që atje ekziston ende rrjedha normale a po, për ni krijues, ta zamë analog në Beograd, Zagreb, apo mos t'them Francë, te ne ka, domethënë te ne s'ka asgjë.

¹ Frengjisht: *tantieme*, një rrogë shtesë që u ipet anëtarëve të bordit të drejtorëve, drejtorëve të kompanisë, dhe zyrtarëve të lartë nga profiti neto i kompanisë.

² Gjermanisht: *schund*, pleh. Në kulturë ky term kryesisht përdoret për të klasifikuar një krijimtari si artistikisht inferior, të pavlerë.

Pjesa e Pestë

Rafet Rudi: Pas kthimit, domethënë prej Parisit, ndoshta n'atë kohë do t'thotë te... s'po di deri ku mrrimë, a po. Domethënë po e tregoj shkurtazi e po vi te kjo. Domethënë pas kthimit nga Parisi, unë kom vazhdu domethënë jetën t'them krijuse, apo aktivitetin tim në Prishtinë. Por, kjo kohë domethënë lidhet ma tepër me aktivitetin tim si dirigjent, meqë vitin '80-ta pikërisht disa javë pas kthimit nga Parisi, unë kom fillu të punoj me korin profesional të radios. Krejtsisht e rastsishme ka qenë ajo. Nuk ka qenë një, një profesion që unë e kom andrru kur e kom regjistru dirigjimin. Absolutisht nuk osht'. Unë s'kom mendu, unë se kom studju degën e dirigjimit për t'qenë dirigjent. Aq ma pak për me qenë dirigjent i korit, qe unë s'e kom pa fare veten aty.

Ajo ka qenë rasisht domethënë angazhimi im në radio dhe... por osht' e randsishme për krijimtarinë time, për aktivitetin tim e për zhvillimin tim si muziktarë, meqë shtatë sezona të ardhshme, '80, '87, unë kom qenë domethënë i lidhun me korin e radios dhe me aktivitetet që ka pasë kori i radios në festivale të ndryshme të Jugosllavisë. E nuk kanë qenë t'pakta. Domethënë kanë qenë domethënëse. Mandej edhe prezentimi i korit në rrjetin, domethënë në, në rrjetin radiodifuziv jugosllav ka qenë shumë prezent. Domethënë, për atë kor kanë mundur të, ta ndëgjojnë, ta njohin edhe kolegët e mi, ta zamë ndoshta në Lubljanë, në Sarajevë apo kshtu, për shkak se ka qenë ni treg unik kulturor, a po.

Domethënë krejt ato vite kanë qenë të lidhur me aktivitetin tim të korit, dhe krijimtaria disi ka qenë e lidhur me këte. Por, duhët thënë se në këtë fillim të viteve '80-ta ka fillu të degradohët jeta kulturore te ne. Domethënë ai, ajo shpresë që ishte dikun n'fillim të viteve '70-ta, dhe ai interval ka qenë jashtzakonshëm në kulturën, domethënë Kosovës. Unë mendoj që asniherë kultura kosovare nuk do ta ketë ni periudhë të tillë intenzive, dhe kur e shohim tash, se ajo ka zgjatë vetëm gjashtë-shtatë vjet, impresive kanë qenë si jonë formu instutucionet, aktivitetet e ndryshme edhe n'fushën e muzikës përpos fush... fushës së gjërë kulturore. Dhe '81-shin me, domethënë natyrisht me '80-shin vdekjen e Titos e kshtu me radhë. Në '81-shin ka filluar të ndryshon klima politike, dhe ka pasë reperkusione natyrisht në fatin edhe t'muzikës tonë, kulturës sonë dhe rrjedhimisht edhe ka pasë ndikim edhe në punën time.

Domethënë, përkundër që chanset kanë qenë shumë të mdhaja që n'atë kohë të, të shkon përpara, të avansohët krijimtaria e, krijimtaria e kompozitorve tonë me festivale. Mandej të rritët orkestra, akademia të zhvillohet e kshtu me radhë, ajo do t'thotë ka pasë ni zbritje. Mjerisht, a po, për shkak t'ndërrhyrjes së vrazhdë të politikës në, në domethënë në veprimtarinë kulturore, a po. Derisa, '87-shën mu m'osht' ndërpre domethënë puna në kor, dhe ka qenë problematike edhe shfaqja ime kshtu mendoj publike si kompozitor, a po, nëpër radio e kshtu me radhë, për shkak disa problemeve domethënë që jonë shkaktu politike.

Eh, domethënë në momentin kur chanset kanë qenë, t'them për atë kohë optimale, që të merr hov institucionet kulturore, jeta kulturore e kshtu me radhë, ajo ka pasë ni zbritje domethënë derisa me, në '90-tën osht' mbyll Radio Televizioni. '91-shën jonë mbyll praktikisht t'gjitha instutucionet dhe ne kemi hy në ni zonë të tmerrshme, domethënë të jetës kulturore dhe natyrisht edhe kombtare gjithsesi.

Po, tash shiqu, nëse shiqohet krejt ai ambient i gjërë nga prizmi i kulturës, ajo ka qenë, arsimit, kulturës edhe arsimit, ka qenë ni periudhë domethënë fatale, fatale.

Unë kom fillu n'atë kohë të merrem mjaft me shkrime, me shkrime, për shkak se s'kom pasë mundësi tjetër edhe të shprehjes. Kom punu me "Revistën Koha". "Koha" ishte, domethënë ajo ka qenë '91-shën, '94-shën, '95-shën. Domethënë kom pasë një rubrikë. Redaktori ishte Eqrem Basha dhe unë isha ni vjet e ma shumë, domethënë çdo javë shkruja për, për ngjarje të ndryshme të muzikës, dhe ato shkrime ta zamë ndoshta dikun njiqind shkrime n'atë periudhë. Kur e shof se me çka jonë, cili osht' subjekti i atyne shkrimeve.... Bile, në ni anë domethënë më impresionon që kom mundur të merrem me ato, me ato tema n'atë kohën tepër të vrazhdë a po, por n'anën tjetër tash më dukët gati t'kota që kanë qenë, a po.

Mund ta merrni me mend, për shembull unë kom shkrujt për kompozitor për 70 vjetorin e Boulezit domethënë, për domethënë përvjetorin e Michael Tippett, kompozitor që, modern që nuk njifën bile. Vështirë njifën n'qendra tjera e jo këtu. Për shkak se unë me revistë, kom qenë në komunikim me revista franqeze. *Le Monde de la musique* [Bota e Muzikës] kom qenë i parapagum kshtu, dhe i përcjellsha disa shkrime që ishin. Ta zamë, mund ta merrni me mend çfarë paradoksaliteti. Në '95-shën osht', Mitterrand³, e hapë qytetin e muzikës *Cité de la Musique* [Qyteti i Muzikës] domethënë, dhe shkrimi në "Kohë" ka qenë ni ditë para se ai ta hap ate. Domethënë, me çfarë tema aktuale jom marrë, për... përvjetorin e Schonbergut apo kshtu me rradhë.

Domethënë unë, tash më duket se unë kom jetu në ni ishull, domethënë krejtsisht i vetmum, krejtsisht i vetmum. N'qofse shiqohen ato temat, vetëm temat jo niveli i shkrimeve, po temave, domethënë ajo ka qenë ni vetmi e tmerrshme. Për shembull zej [zëre] të shkrun për Anton Webern, të shkrun për Edgard Varèse n'atë kohë me, për Cage të shkruhët. Krejt ato shkrime, krejt ato që jonë përmbledh edhe në Eseistika që osht' përmbledh në këtë librin tim "Sprova Estetike", datojnë nga ajo kohë, a po. Domethënë me, jom marrë me, domethënë jom preokupu, jo jom marrë, me libra fillozofik e estetike, e kshtu me radhë, a po.

Ose, për shembull ni detal. N'atë kohë viteve domethënë '90-ta tash a po, domethënë pas ktyre teposhzës të viteve '80-ta, '90-ta kur u ndërpre, në mesditë u takonin njerzt e kulturës, njerzt e... intelektual kush... kushtimisht në disa lokale. Ju ndoshta kte pak e dini, Elide, ose Dora ose kshtu, dhe aty zhvilloheshin debate natyrisht politike, dhe pastaj ka ora tre masdite, osht' dashtë që gjithë të shpërndahemi apo të mbyllemi nëpër shtëpija. Dhe unë pata bo përpjekje ta marrë ni radio cilsore kshu a po, dhe e ndëgjojsha programin e tretë t'Beogradit, dhe n'atë, n'ato, n'atë shtet rrethim ku... orë policore, a po, unë e ndëgjojsha Arvo Pärt për shembull dhe dëshmi osht' ktu ni mori kasetash që unë i, i, i inçizojsha nga programi i tretë i Radio Beogradit që e ka pasë ni orientim shumë t'lartë në kuptimin e, e promocionit të muzikës dhe temave kulturore moderne, a po. Po, nuk po them që ajo ka qenë e frytshme. Po, ka qenë ni, ni thjesht ni, ni kshtu ni paradoks në, në jetën time. Ni situatë kshtu, kshtu paradoksale dhe sh... kontraverze, kontraverze.

³François Mitterrand, President i Francës nga 1981-1995.

Mund ta merrësh me mend, ni ndjenjë shumë e, e, ni emocion që e kom pasë n'atë kohë që d... vështirë e kom ta spjegoj. Ta zamë kur kom ndëgju ndoni muzikë moderne, unë jom, ose korale moderne, a po. Muzikë me t'cilën osht' marrë kori i radios n'atë kohë, a po. Domethënë një orientimi krejtsisht avansus, a po. Unë kom pasë kshtu ni ndjenjë shumë emotiv... emocionale, a po. Jo për shkak t'muzikës, për shkak ambientit që ka mund ajo muzikë të krijon për atë kohë, dhe munësh, pse... unë besoj që nuk osht' kurkush i marrë ta ndëgjon Anton Webern edhe nuk mund ta përjeton si Tchaikovskyn, a po. Ato, e përjeton atë vepër intelektualisht, por jo emocionalisht. S'ka të, çka të mallëngjen ajo, a po, dhe, kurse une mallëngjeheshem, mallëngjehesha. Por jo për muzikën, po për ambientin që ofron ajo muzikë, që ishte tash e largët, e...

Mirë, kjo ishte viteve '90-ta, dhe natyrisht intimisht më dhimët ajo periudhë e jetës. Domethënë absolutisht unë nuk mund t'jem idealist n'fushën kombtare që ne kemi ba këte shumë, në fushën domethënë kombtare, a po. Avansime, n'kuptimin e ni, domethënë një vetëdijsimi kombtarë që n'atë kohë osht' bo por, sigurisht ajo osht' e vlefshme, po n'pikpamje krijuse ajo është fatale, a po. Për mu kanë qenë fatale dhe mu m'dhimën ato vitet, a po.

Erëmirë Krasniqi: E çka ka ndodhë me muzikën n'atë kohë?

Rafet Rudi: Jo, s'ka pasë fare asgjë, a po. Bile unë '93-shën, disa ditë para se të mbyllet Instituti Albanologjik si institucion i fundit që është mbyll, a po, bile ka skena që dihet Anton Çetta osht' rreh, kshtu jonë të tmerrshme. Ne disa ditë përpara e, e kom, kom bo përpykje ta aktivizoj korin. Kjo osht' dheteri i vitit '93. Jemi mbledh disa njerz të korit dhe kemi ekzekutu, ka qenë tematikisht ai koncert. Osht' majt në, në shkallët e Institutin Albanologjik, krijimtaria sakrale shqiptare, ka qenë kshtu. Ne kemi ekzekutu Nolin, domethënë, po Fan Nolin disa vepra. Une pata shkrujt ni vepër, ni lloj kantate t'vogël me, me ndikim të këndimit liturgjik Arbresh, e kshtu me radhë. Mirë, ajo ka qenë tematikisht, qëllimisht e bërë ashtu. Por, ka qenë një aktivitet që pastaj edhe ajo është ndërpre, edhe ka pasë domethënë...

Petrit Çeku: Ku e bonët koncertet, koncertin?

Rafet Rudi: Në, në Institut Albanologjik.

Petrit Çeku: Ah, po. Veç qajo po m'intereson rreth koncertit.

Rafet Rudi: Po, Institut Albanologjik dhe disa ditë pas asaj, Instituti osht' mbyllë. Ndërtesa e fundit, a po, dhe ka pasë ni, ni heshtje shumë të madhe. Kalimthi tash kshtu, them atëherë veprat unë i kom dërgu te kolegët në Shqipri, dhe atje jonë ekzekutu mjaft, n'këtë kohë. Domethënë '95-shën, '96-shën, '97-shën, '98-shën, kom qenë shumë prezent në Shqipri, domethënë se atje pat' fillu muzika moderne të, të aktualizohet dhe ata kanë qenë t'interesum, dhe kshtu jonë ekzekutu.

Mirë, por une mendoj që ajo o ni errsirë complete e kulturës tonë. Natyrisht ne e kemi kqyr me ideale kshtu. Une nuk kom mujt me e pranu, a po. Unë nuk kom mujt se unë kom qenë... jo që ma i

vetëdijshmi, secili ndoshta pak me një rezonim t'mirë e ka ditë që osht' ajo fatale për kulturë, a po, domethënë, po nuk kanë dashtë njerzit ta pranojnë, a po. Fatale për arsimin, që praktikisht reperkusionet në tash i shohim pas saj, a po. Ajo është fatale. Ai instrumentalizim aq i madh i arsimit, a po. Domethënë natyrisht me qëllime ma t'larta, gjithësi domethënë, po ajo është... nuk është msu ajo, nuk osht' punu ajo, kshu me radhë.... Dhe mrrimë në vitet domethënë '90-ta, domethënë dhe nuk ka pas, '99-ta domethënë deri te...

Erëmirë Krasniqi: Kur ka nis lufta, ku ishit gjatë luftës?

Rafet Rudi: Po. Kshu, unë kom qenë gjysmën e kohës të atyre tre muajve, kom qenë këtu brenda. Natyrisht, jo në këtë shpi, në një shpi tjetër që kom, kemi qenë n'qendër t'qytetit. Pas peripetive në kalim t'kufinit, që s'ka qenë, domethënë të suksesshme të kalimit tim në Maqedoni, a po. Unë jom kthy edhe ni muj ditë pastaj kom ndejt ktu, dhe ma vonë kom kalu. Por kur, pjesën tjetër ta zamë mujin maj edhe deri n'çlirim, unë kom qenë në, në Shkup, dhe aty osht' ni storje interesante domethënë që lidhet pastaj me punën time dhe në organizimin e festivaleve, kshu se... të pas luftës. N'atë kohë, unë kom qenë në kontakt me Ilir Bajrin, me t'cilin kom bashkpunu ma parë, a po. E kom pasë ni lloj bashkpuntori kshu. Në kuadër të ni aktiviteti pak t'çuditshëm t'ato viteve '90-ta, të aktivizimit t'ni okteti, okteti vokal. Une th... hiqja, bile kemi realizu edhe vepra domethënë Bachun e Schubert e kshu me radhë, a po. Po, ajo osht' ni storje minore.

Petrit Çeku: Kjo nuk po m'dokët aq minore, me e, nëse mujm edhe pak mu kthy në '90-tat... t'gjitha këto...

Rafet Rudi: Po. Shiqo, ai ka pasë koncertet, koncerte sporadike. Për shembull, bile unë atëherë kom qenë shumë aktiv n'kuptimin edhe t... ose të pjesmarrësit direkt ose si kritik, a po. M'kujtohët për shembull ni koncert shumë tërhekës, shumë i mirë i Sihanës, Lejlës në Kishën Katolike, domethënë ku e kom lidhë une me, domethënë koncerti osht' zhvillu dhe osht' nalë drita domethënë, dhe ato dya kanë fillu, artistet tona natyrisht shumë t'mira, kanë fillu të vazh... kanë vazhdu të ekzekutojnë, a po, edhe.... M'kujtohët une pata shkrujt kritikë, domethënë ajo ishte një, në një mënyrë simbolike ajo errësirë e jetës kulturore, domethënë ai koncert, a po.

Ne bënim kshu koncerte sporadike. Për shembull, të them në sh... në lokalet e shoqatës t'ëkompozitorve, unë e kom shenu domethënë përvjetorin e Mozartit. Ka qenë '91-shi, përvjetori i Mozartit, dhe ne e kemi shënu me, me këto shkrime të ndryshme, me koncertin, ato, n'atë dhomën e... atëherë kemi mendu sallë që osht' ajo, (qesh) a po. Ajo ka qenë ni dhomë ma e vogël, sa gjysma e ksaj dhomës poshtë {tregon me dorë kah dhoma}, kshu. Po, ka pasë 52 karrika, këte e di se kom qenë shumë një agil kshu në ato organizime. Ato jonë mbajt, por ato kanë pasë një ndjenjë kshu idea... idealizmi fantastik, a po. Ireal a po, domethënë se jemi tu bo diçka. Ne, ne kemi kundërshtu me, me duke e, duke e kriju ni iluzion t'jetës kulturore, a po. Ajo mirë osht' për çashtje kombtare, por për çashtje domethënë artistike osht' shumë vështirë.

Petrit Çeku: Për me përmbledh vitet e '90-ta, m'kujtohet ni bisedë private njëherë patët krahasu Luftën e parë botnore kur Raveli ka marrë pjesë edhe si vozitës i ambullantës e gjana... i patët spjegu ju m'patët thanë që...

Rafet Rudi: Ashtu. Nuk, nuk po m'kujtohet ky detal.

Petrit Çeku: Më patët thanë që ai megjithatë kur u kthy në Paris, aty ka pasë aktivitete kulturore, përkundër që ka qenë luftë botrore!

Rafet Rudi: Po, po. Une mendoj që po t'kish qenë jeta e konsolidume para vitit '90, une mendoj që kish pasë edhe aktivitete paralele. Por ne nuk kemi pasë shumë, a. Duhët pranë.

Petrit Çeku: Po ka qenë e ndalume...

Rafet Rudi: Po, po, domethënë ka qenë orkestrën s'ke mujt me e aktivizu, a po. Këto kolektive, se ato kanë qenë problem, edhe kshtu fizikisht t'i mbledhësh njerzit. Se tubimi pak ma i madh i njerzve, ka qenë problematike, a po, domethënë. E kshtu me radhë.

Domethënë, ajo ka qenë ni zyrtësi e madhe, '90 e... në kohën kur une isha në Shkup, më thirrë domethënë Vanessa Redgrave. Ajo ishte në Kanada, domethënë, edhe telefonin ia ka dhënë Iliri, Iliri që kishte komunikë '98-shën kur ka qenë Vanessa këtu n'ato ikjet në male. Ajo ka qenë një aktiviste, ka shku edhe aty o njoftu me Ilirin, Ilir Bajrin, dhe Iliri e ka, shumë e ka dashtë Vanessa. E kanë pasë një relacion shumë të çuditshëm. Unë, se ne kemi bashkpunu mandej shumë me te, domethënë jashtzakonisht Prishtinë, këtu, dhe e di këte... dhe Iliri i ka thanë se për një, një iniciativë qe ajo ka pasë ndërmend ta krijon një festival këtu. Festival që osht'... ma vonë e ka qujt "Festival Kthimi", a po, domethënë... se ndoshta mirë osht' të kontakton mu për ndonji, ndonji aktivitet, n'fushën e kulturës, Enver Petrovcin në fushën e teatrit, kshtu.

Dhe ajo më propozon për një festival që do të mbahej menjëherë në ditët e para pas luftës, dhe që, praktikisht ajo e parandjente që ajo do t'përfundoj, a po, dhe ne e dishim që do t'përfundoj, kshtu, dhe ne morrëm, domethënë fillum bashkëpunimin. Ato ishin mandej bashkëpunime, atëherë kishte, kishin fillu dhe e-maillat t'i shfrytëzonim, a po, internetin. Unë isha në Shkup, punojsha me ni radio, Radio 21-shin domethënë që ishte aktivizu atje. Domethënë kjo osht' fundi i jan... i majit, a po. Domethënë, mu para mbarimit të luftës, dhe ajo kishte një ide t'jashtzakonshme me i thirrë emnat shumë të mdhaj, dhe ka thirrë. Në emetin e tyre edhe Philip Glass, por edhe emra t'fushës tjetër, aktor Frako Nero, e t'muzikës zbavitëse. Do emra që juve nuk ju thotë shumë, por për shembull Lulu Kennedy-Cairns ka qenë, shumë e njoftun një e muzikës Rock, muzikës në Angli, viteve.... Ajo ka qenë këtu n'koncert domethënë n'kuadër të këtij manifestimi ka qenë Patricia Kase, kshtu me radhë.

Dhe u arrit domethënë që n'shtator, a po, shtator të, të mbahët ky festival. Edhe u mbajt festival ku n'kuadër të festivalit osht' dasht edhe Philip Glass të merr pjesë, dhe ka marrë pjesë, por jo në Prishtinë meqë skishte domethënë ishte e pamundun ktu sallë t'përshtatshme me piano të gjindet...

dhe u mbajt festivali me poster në Shqipe, natyrisht edhe anglishte, me festival domethënë të Prishtinës. Por koncerti i Glassit u mbajt në sallën Univerzale, dhe ne me, shkonim domethënë në kuadër të...

Petrit Çeku: Koncerti osht' në Shkup a po?

Rafet Rudi: Në Shkup, n'sallën Univerzale në Shkup, dhe ai mbajti koncert kurse ne komunikum. N'pregaditje ishim n'komunikim me Philip Glassin. Aj ishte at... ai ishte një, një, një festival domethënë humanitar, a po, domethënë ku emrat shumë t'njoftun domethënë Elton John, Mikhail Baryshnikov, e kshtu me radhë ishin donator a po, të këtij festivali. Nuk po m'kujtohet edhe emra sh... botërisht të njoftun. Arritëm domethënë n'atë kohë që ishim në Sh... në Shkup të ikur, Iliri në Itali edhe Vanessa, të komunikojmë, dhe menjëherë pas, pas mbarimit të luftës Vanessa erdh këtu dhe ajo vinte gjatë mujit korrik, gusht, ka ardhë disa herë me radhë. U bo redaksia e festivalit, dhe u mbajt ai festival, me shpresë dhe me ambicie që ai të mbetë festival, domethënë festival tradicional.

Por, mjerisht nuk u mbajt, nuk u, nuk qëndroi si i tillë. Por, në njëfarë mënyre, përmes atij festivali u krijuan festivale tjera si "Remusica" e kshtu me radhë, a po, dhe bile me insistimin e Vanessës dhe të ni regjisori Gotar që ishte... me radhë, vendosi Vanessa që ta krijoj një qendër t'muzikës moderne. Unë e bona atë, atë projektin, e kurse e luti Philip Glassin që ai t'jetë kryetar nderi. Natyrisht, ai nga mirësjellja domethënë pranoj, por ne nuk e vazhdum atë, atë bash... për atë mundësi që të vazhdon ky bashkëpunim konkretisht me Philip Glass. Më vjen keq që ajo, nuk u shfrytëzua ai moment. Ai ishte i predisponum, ishte i... ai e dinte saktësisht se ku ka ardhë, n'festival e kshtu me radhë. Nji emën shumë, shumë domethënë edhe për ne, domethënë sidomos për ne të promovimit të muz... kulturës sonë muzikore në botë, kshtu që ta kemi në, në, në atë om... ombrellë a po, e një emën të tillë.

Sidoqoftë, ai festival u, u mbajt, por ai festival ma tepër u shëndrru në një koncert, u mbajt në këtë hallën që osht' djegë, dhe ka pasë dikun pesë-gjashtë mijë vetë. Domethënë... bile në festivalin e fundit "PrimFest" osht' shfaqë ni film dokumentar për ate, të ni regjisori m'dukët kanadez apo kshu që, unë nuk e kom pa atë, rast. E kanë pa njerzt edhe për krejt rrjedhën, përgatitjen e festivalit, se ajo ka qenë intenzive, osht', osht' u pat' formu një zyre ku vinte Vanessa, ku mbanim këto mbledhjet t'vazhdushme. Jo, dy-tri, por shumë. Ne punojshim në, në bazë ditore, ishim n'komunikim për këtë manifestim se ishte domethënë, mund t'ju tregoj ni detal. Katër aeroplan domethënë special kanë ardhë për atë shfaqje. Ka ardhë një kor i Kandasë, domethënë ka ardh Jaques Lang ky Ministri i Kulturës të Francës. Ai osht' shumë personalitet domethëns për kulturën Franqeze, për shkak se ai e ka ba atë ditën e botrore të muzikës, 21 qershorin, ai osht' iniciator. Ai ka qenë aty prezent, e shumë të tjerë, emra shumë të mdhej. E, domethënë ishte një entuziazëm e kshtu me radhë.

Sidoqoftë, çka mbeti nga ajo? Mbeti qendra për muzikën e re që ne e formonim, e formum ato ditë dhe nga ajo qendër u formu festivali "Remusica", a po. Domethënë dy vite, dy vite ma vonë, tri vite ma vonë, pikërisht nga qendra muzikore, domethënë. Mandej osht' formu si qendër muzikor... muzik... qendra e muzikës moderne, kshtu përafërsisht, dhe mandej që nominalisht ende ekziston, ndonëse

s'ka kumeditë çfarë veprimtari t'veçantë për shkak se osht' e përqëndrime ajo qendër vetëm në organizimin e Festivalit "Remusica".

Sidoqoftë nga ajo fillun, nga ajo iniciativë e Vanessës a po, nga ato organizimet, ajo ishte jashtzakonisht e, e aftë në organizim, a po. M'ka befasu gjithmonë ai personalitet, ajo nxitje domethënë ajo energji, ajo që të punon në këtë drejtim. Domethënë, përmes asaj u ngjallën, u ngjall jeta muzikore, menjëherë, a po. Në vitin 2000, 2001, 2002 lindën një mori festivalesh. S'pari "Festivali i muzikës kamertale", "Remusica", e kshu me radhë. Domethënë, dhe natyrisht ambienti kulturor në, ambienti në fushën e muzikës morri një pamje krejtësisht tjetër. Për diçka ka qenë jashtzakonisht mirë, se fillun aktivitetet të shtohën, siç edhe dihet kshu koncerte të shumta të formacioneve sidomos kamertale që vinin nga jashtë që u bonte si donacion i ambasadave, i programeve kulturore të fondacioneve të ndryshme. Domethënë deri, sigurisht në periudhë prej një dhetë vjeçare, një mori fondacionesh mundsonin. Ata dërgonin, ata nuk jepnin të holla, por dërgonin artistë, a po, nga Franca, nga Kandaja, nga Suedija e kshu me radhë, a po, nga Britania e Madhe dhe jeta muzikore mori një pamje jashtzakonisht t'mirë.

Por, në, në kuptimin e organizimit institucional pat' një ngecje, ka dhe një ngecje. Mjerisht ne nuk e, nuk arritëm që t'i rujm disa institucione kyçe, si Radio Televizioni, produksionin, produksionin e Radio Televizionit nuk arritëm t'i rujm, që ajo produksioni ishte një vend ku inçizohej, ruhej krijimtaria e muzikës tonë. Domethënë, ajo u zhduk fare, fizionomia u, u shëndrru në diçka tjetër e kshu domethënë, po vazhdojmë kshu.

Natyrisht, osht' aspektet e mira, por mu më v... më dhimbet që ekzistojnë edhe një, disa aspekte mjaft të këqija që praktikisht osht' tu e përjetu jeta e jonë, krijimtaria jonë, a po. Derisa n'atë kohë t'maparshme muzika, krijimtaria jonë ruhej, inçizohej, arkivohej, e kshu me radhë, sot nuk ka kurrfarë arkivimi i krijimtarisë tonë. Radiot nuk kanë inçizime t'krijimtarisë tonë, nuk shprehin interesim që ato të ruhen, të arkivohët. Osht' jashtzakonisht e dhimbshme dhe fare jo, domethënë unike, për ambientin t'kyre qe... rajonal. Derisa qendrat tjera e kanë rujt disa, a po, këte, te ne domethënë kjo osht' zhdukë. Rujtja, arkivimi, stimulimi i krijimtarisë e kshu me radhë, a po. Bohët stimulimi ad-hoc i iniciativave t'veçanta të festivaleve, po ato nuk ruhen e kshu me radhë.

Ndoshta "Remusica" ka një, një, falë edhe natyrisht atë dëshirës time, domethënë ka një arkivë. Ne kemi, për shembull, prej 2002-shit një arkivë "Remusica" të rujtur, të krijimtarisë tonë dhe i vetmi vend që ka domethënë arkivë të rujtur të inçizimeve t'kompozitorve kosovarë, por edhe të koncerteve domethënë që janë zhvillu në këtë kohë. Nuk ka ndonjë institucion që e merr përgjegjësinë, obligimin që ta bon, dhe kjo osht' jashtzakonisht negative. A mundeni ta merrni me mend, për shembull prej vitit '80 në mënyrë domethënë stabile ka ekzistuar një ansambël koral profesional, dhe sot nuk gjen kurrfarë shënime për ekzistimin e atij ansambli. Prej '74-shës, '75-shës, ekziston aktiviteti i orkestrës simfonike që ka ekzistuar deri në vitin '90. Në mënyrë institucionale programet kanë qenë krejtësisht të mendimeve e kshu me radhë, domethënë t'planifikime, t'mendime, realizime. Nuk ke asnjë shënim se kush ka qenë anëtarë i atij orkestre. Nuk ka një, një domethënë në institucion që i run kto. Kjo osht'

shumë e dhimshme, dhe nuk jemi të vetdijsëm se sa osht', sa, sa mungesë e madhe do t'jetë për gjeneratat e ardhshme kur dëshirojnë ta bojnë këtë rikonstruim të jetës kulturore.

Fatlumsisht ka edhe njerz që kanë rujt, a po. Nji prej atyre une jom. Në qofse donë të rikonstruohët jeta kulturore, jeta muzikore në vitet ta zamë '74 dhe '90, domethënë arkivin që unë kom pasë fat të mos shkatrohet gjatë luftës, osht' e mundshme krejt të rikonstruohët. Domethënë me data, me data mundet domethënë. Jonë t'gjitha, komplet t'gjitha programet, t'gjitha programet e festivalit. Mund t'i ketë edhe dikush tjetër, a po, domethënë mund t'i ketë edhe kolegu Ballata, por ai viteve '90-ta nuk ka qenë fare ktu, ai ka qenë në Maribor. Ai ka pasë, ai k... domethënë ka qenë ma sistematik në këte, por të tjerët jo. Të tjerët... ose nuk i kanë përcjellë, ose nuk kanë qenë t'interesum, apo kshtu.

Por, po e tregoj këte si nji detal, jo për tu lavdru apo, por si detal të dhimbshëm të jetës kulturore tonë të viteve '90-ta, që s'ka pasë instutucion t'i run dhe mjerisht nuk ka iniciativa t'pas luftës që dikush ta bon rikonstruimin e jetës kulturore deri, deri n'atë kohë. Kjo osht', kjo osht' ni... une s'e kuptoj, a. S'e kuptoj, domethënë instutucionet që nominalisht jonë kulturore, që kanë përgjegjsi kulturore që nuk bëjnë përpjekje ta bëjnë nji arkivë se çka ka ndodhë në vitet '80-ta, '90-ta e kshtu me radhë, a po. Nga këto materiale, qoftë edhe të arkivave private, a po. Qe kshtu, domethënë. Kjo osht' ajo, domethënë në kalim prej viteve '90-ta deri në, në, në këtë kohë domethënë të pas luftës a po.

Petrit Çeku: Nëpërmjet "Remusicës" e keni pa, e keni pasë sigurisht një rrugëtim që n'fillim osht' ndi hovi i energjisë t'mirë, lëvizjeve t'mira mas luftës. A osht' vshtirësu kohëve t'fundit, a osht'...?

Rafet Rudi: Kshtu, unë po, po, p'iu tregoj disa përshtypje t'mija, që supozoj mund t'jenë analoge edhe me festivale tjera. Po, domethënë jonë përgjithsuse. Shiqoni, në fillim ne kemi pasë jashtzakonisht ndihmesë t'madhe, jeta kulturore, muzikore në Kosovë, nga fondacionet e ndryshme. Ta zamë, vetëm t'iu tregoj unë, ta zamë me ProHelvecia unë kom pasë me vite të tërë ansamble nga atje. Me Gaudamus, ni fondacion në Amsterdam pesë-gjashtë vite kom pasë artistë që ata i kanë sjellë, domethënë. Mandej, njejt ka qenë me Britanikët, me Gjermanët, a po, domethënë...

Petrit Çeku: Alliance Française...

Rafet Rudi: Po, Alliance Française, po ata e kanë pasë programin kulturor pranë ambasadës, a po, që domethënë. Por gjithmonë jo, ata nuk kanë qenë t'lidhur me Ministrinë e Kulturës, me Ministrinë e Punve të Jashtme, edhe kjo osht' ni interesant, ni msim për... qe osht' dashtë ne ta marrim a po, që Ministria e Punve të Jashtme të organizon aktivitete të ndryshme kulturore, obliguse për zhvillimin.

Mirë, kjo osht' tash çështje e tjerve që duhen të mendojnë domethënë për këte.... Dhe ne kemi pasë ndihmesë shumë të madhe, domethënë kanë ardhë edhe grupet, bile edhe orkestrat kanë ardhë, a po, këto vite. Me v... me këto vite që tash, e fundit kur ka fillu domethënë ndihma a po, e ktyre fondacioneve të zbehet mos t'them të, praktikisht të ndërpritet, të ambasadave që kanë qenë këtu, në ndërkohë festivali ka marrë nji, ka zënë fill, domethënë ka fillu të jeton jetën e vet, edhe n'raport me, me artistët, fondacionet e ndryshme t'jashtme e kshtu me radhë, dhe falë kësaj, falë kësaj artistët

shpeshherë jonë të interesum të vinë këtu, a po, të jashtëm. Domethënë, iniciativa e tyre tash mund t'jetë, a po, dhe raste të shumta kemi ksi soji domethënë që e kërkojnë një, një bashkëveprues.

Artistët që domethënë të ni rangu t'konsiderushëm, t'konsiderushëm, a po, relativisht të lartë që ju nevojitet për, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre në, në këtë rajon, shpesh na drejtohen. Për shembull, ka pasë kuartet t'saksafonave, ka pasë ni ansambël Pierrot Lunaire që jonë drejtu te ne për koncerte që kanë majt me vite këtu. Jo, pse kanë qenë shumë të interesum, posaqërisht për Prishtinë, apo posaqërisht për "Remusica". Por që t'i gzojnë ata benifitet e tyre ndaj fondacioneve që kanë punu ata, ata osht' dashtë përmos... përpos koncertit që e kanë mbajt ta zamë në Zagreb, ata ju ka nevojit edhe një koncert në rajon. Ky ka qenë kusht, ta zamë, edhe andaj ka ardhë për shembull Trio Fibonacci. Nja dy vite ka pasë koncerte këtu, ose Pierrot Lunaire ka pasë koncert në Zagreb, ka ardhë këtu, jo pse shumë i ka interesu domethënë Prishtina, por ne e kemi pasë benifitin për shkak se atyre ju ka nevojit kjo.

Domethënë, osht' interesant, domethënë "Remusica" në njëfarë mënyre osht' zh... promovu në ni aktor, ni akter në organizimet rajonale, a po. Siç osht' "Ditët e Muzikës Maqedone" në Shkup, siç jonë festivalet tjera. Për shembull, unë para disa vite kom qenë në Beograd, mysafir i tyre i festivalit "Bemusit". Nuk ndryshon festivalet e tona nga ai i "Bemusit" shumë. Nuk osht' ajo diferencë që ka qenë para 20-30 vet... vjetve, domethënë mes festivalit tonë ktu dhe në Beograd. Atëherë ka pasë donacione shumë të mdhaja atje, kur këtu s'ka pasë hiq. Kurse une e kom pa krejt atë festival dhe ai osht' sigurisht ma i mirë se këtu, por dallimi shumë i vogël. Shumë i vogël, po flas për festivale. Domethënë kjo osht', kjo osht' interesant.

Petrit Çeku: Si është, si e keni momentalisht estetikën, si me thanë çfarë...?

Rafet Rudi: ...qëndrimi. Shiqoni, domethënë ndoshta kjo dhe domethënë, osht' e kuptushme në këtë, në këtë moshë të cilën jom, që më mundson tash ta shof në një vazhdimsi tërë atë zhvillim timin, por edhe zhvillim të bindjeve t'mija ndaj artit. Në kohën e fundit, natyrisht unë jom i, i aktivizum në korin e filharmonisë, po dhe punoj edhe me orkestër, këto veprat e mdhaja vokalo-instrumentale, kohën e fundit jom duke i realizu.

Kurse, në pikpamje të krijimtarisë, në pikpamje të, të bindjeve t'mija estetike ka një, ka një ndryshim t'madh n'kuptimin e rivlersimit të një periudhe mjaft të madhe me t'cilën unë kam qenë i preokupum. Domethënë të, të problemit të modernitetit si të tillë, a po, që ka qenë për mu jashtzakonisht preokupuse. Ndonjherë ka qenë kandshme ai, ajo ambicie, ndonjherë ka qenë dhimbshme ajo ambicie për shkak se s'kom pasë mundësi ta përcjelli ate. Sidomos, viteve domethënë '90-ta kur s'ka pasë kurrfarë komunikimi.

Por, n'kohën e fundit domethënë unë jom në ni periudhë kur e, e, e nij një këngë dehjeje, do te kisha qijt kshtu, të bindjeve t'mija krijuse, dhe nuk, nuk kom dëshirë shumë ta lëndoj Rafetin e di... da... dikurshëm, por ta qortoj po. Domethënë n'kuptimin se ai tepër ent... ajo ndjenjë entuziaste për gjana t'reja, për muzikë moderne që ka qenë e por... personifikume në muzikën atonale, a po.

Une mendoj që ka qenë pak, tepër e sforcume. Koha e ka tregu se dhe ajo, ajo, ajo muzikë, ajo avangardë e viteve '60-ta, megjithate ka qenë një kohë... megjithate eksperimentale. Unë e di që profesori im në Paris, nuk do t'kishte mendu si një atonalist i përбетum që kjo osht' kshtu. Por unë e shof, përkundër shfaqjes së emrave të mdhej të shek... në shekullin e XX ta zamë të Stockhausenit, Boulezit apo emrave të tillë, une mendoj se ka pasë një, një, një, një vetëknaqësi domethënë me atë komoditet të asaj muzik... komoditet krijus që ka mundësu zhvillimi edhe ekonomik i vendeve, dhe ai komoditet që ai të jeton në një kohë jo reale. Jo reale.

Krejt ajo krijimtari, në qofse domethënë instrumentisti, për shembull veprën e Cage ngritet përmë piano dhe bon do lëvizje edhe e qun vepër muzikore, mund t'ketë... interesant më është dukë ndoshta kur e kom pa dikur në Paris, po une mendoj që megjithate njeriu duhet t'vetëdijësohemi, nuk osht' natyrshme. Piano osht' për m'i ekzekutu, a, jo për me goditë, a po. Domethënë pianon, a po, ose me e thy pianon. Domethënë, ato tendenca që u spjegova për, për festivalin e "Tribunës së krijimtarisë muzikore", ato kanë qenë ekstreme. Aty osht' marrë domethënë druri dhe me sharrë e ka pre drurin për me e qujt muzikë, a po. Mendoj që, e shof se një entuziazëm që ka, jo që kom shkrujt une shumë moderne n'atë kohë, por më duket se ka qenë e sforcume në periudha të ndryshme të krijimtarisë time. Unë besoj që po t'kisha qenë ma i qetë në këtë drejtim, ndoshta dhe vepra ma t... ma t'vlefshme kisha shkrujt gjatë, domethënë jetës time, a po. Domethënë ma, ma solide, ma, ma reale, a po, ma reale.

Mendoj se, tash kur jemi në një periudhë të një postmodernizmi t'thellë, a po, domethënë mendoj se e shofim kotësinë e disa gjërave që kanë qenë. Ndoshta janë këto krejtsisht subjektive. Ndoshta një kolegë i imi në një vend tjetër të zhvillum, të zhvillum, nuk e ndinë kshtu. Une për veti e ndij këte, dhe për ate në njëfarë mënyre në vitet e fundit, në dhjetë vjetshin, pesëmdhjetë vjetshin e fundit mjaft ka ndryshu edhe fizionomia e krijimtarisë time, në kuptimin e, prapë po e quj këndelljes krijuse, a po. Une mendoj që edhe një vetëdijësimi për një realizëm, vetëdijësimi për një rrjedhë ma normale të krijimtarisë muzikore, a po. Domethënë ma reale, ma e afërt me publiku, ma emotive. Nuk mundet emocioni të anulohët në, në vepër muzikore, në emër të një moderniteti, a po. Që praktikisht, ka qenë shumë e afërt me muzikën atonale, a po, të... domethënë një tëhuajsim praktikisht, a po, që.... Une mendoj që, koha e ka, nuk e ka verifiku në çdo element, atë, atë orientim të tillë të muzikës ekstreme atonale, të shkëputjes nga, nga publiku, nga emocioni. Nga emocioni i thjeshtë, a po.

Domethënë, vepra duhet të, me, domethënë me publikun, me konsumusin të komunikohët në planin emotiv. Unë mendoj se nuk mund të arsyetohët me komunikime intelektuale vetëm. Një i... një intelektualizëm aq i madh, që unë për veti kom aspiru, jo gjithmonë ka arritë, kom arritë por kom aspiru, nuk mund ta zavendson komunikimin emotiv të, domethënë të veprës me publikun. Domethënë, ose atyne gjymtyrëve, krijusi, vepra artistike, publiku, domethënë ajo lidhje duhet vetëm në rrafshin emotiv. Mandej fillohet të spjegohen, apo të vinë në shprehje elementet tjera. Profesionaliteti, porosia estetike, intelektuale e kshtu me radhë. Por, ai, ai indi emotiv une mendoj që nuk guxon të humbet në krijimtari, dhe ka pasë një rrezik që nga avangarda e viteve '60-ta në Evropë, të humbet kjo. Pavarsisht që e kanë, propagatorët e kanë, propagusit e asaj muzike e kanë arsyetu

çdo vepër, çdo përpjekje, por ajo domethënë me kohë nuk është, nuk e ka arsyeu gjithmonë, a po, vetveten. Domethënë, elementi emotiv që osht' bazë e këtij indi, a po, që i lidhë këto gjymtyrët duhet t'jetë, domethënë kompozitor, krijusin, veprën dhe publikun, konzumusin, duhet t'jenë gjithmonë domethënë prezent. Pa ate, artin vështirë që mund të, të ketë ardhmëri në një t'ardhme.

Erëmirë Krasniqi: Shumë falemnderit!

Rafet Rudi: Qe, kshtu, qe kshtu. Mirë!